



Instituti i Kosovës për Drejtësi

Kosovo Law Institute

Kosovski Institut Pravde

23/2020

DREJTËSIA

CIVILE

2019

Nëntor, 2020

Autorët: Driton Nocaj, Shqiponjë Gashi dhe Valentina Shahini-Grajçevci

Ekipi i Redaktorëve: Betim Musliu, Ehat Miftaraj, Gzim Shala dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë”, i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD në partneritet me Iniciativa për Progres – INPO.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Nëntor 2020

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	5
2. Metodologjia.....	7
3. Korniza ligjore.....	8
3.1. Standardet e GjEDNj-së mbi procedurat gjyqësore në çështjet civile.....	10
3.2. Përgjegjësia ligjore e Këshillit Gjyqësor për sigurimin e një sistemi të drejtë dhe objektiv 14	
4. Ngarkesa me lëndë civile në Gjykatat Themelore dhe degët e saj në vitin 2019.....	15
4.1. Performanca e zgjidhjes së rasteve civile në Gjykatat Themelore gjatë vitit 2019	19
4.2. Mënyra e zgjidhjes së lëndëve civile gjatë vitit 2019 nga Gjykatat Themelore të Kosovës 22	
5. Ngarkesa me lëndë civile e Gjykatës së Apelit në vitin 2019	24
5.1. Performanca e zgjidhjes së rasteve civile në Gjykatën e Apelit	26
6. Trajtimi i rasteve civile në Gjykatën Supreme	28
7. Gjetjet e monitorimit të IKD-së në trajtimin e rasteve civile	29
7.1. Dështimi i sistemit gjyqësor për të zbatuar detyrimin kushtetues për zgjidhjen e lëndëve në kohë të arsyeshme	30
7.2. “Ping-pongu” gjyqësor në rastet civile	43
8. Annex 1: Analizë e rasteve civile të monitoruara ndër vite nga IKD.....	46
9. Rekomandime.....	71

Lista e shkurtesave:

GjA	Gjykata e Apelit
GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GjTh	Gjykata Themelore
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KEDNj	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
LPK	Ligji për Procedurën Kontestimore
LPP	Ligji për Procedurën Përmbartimore

1. Përmbledhje ekzekutive

Përkundër garantimit të efikasitetit në letër, drejtësia civile vazhdon të jetë drejtësi e vonuar për qytetarët e Republikës së Kosovës. Kushtetuta dhe ligjet e Republikës së Kosovës kanë garantuar efikasitet dhe cilësi të drejtësisë civile për të gjitha kontestet juridiko-civile. Por, përballë kësaj, IKD gjatë monitorimit sistematik të drejtësisë civile gjen se këto garanci kanë mbetur në letër, dhe të pazbatuara në praktikë. Kjo pasi gjetjet e monitorimit të IKD-së tregojnë se procedurat gjyqësore civile zvarriten në pothuajse secilën fazë procedurale, që nga caktimi i seancës përgatitore, përgjigja në padi, shqyrtimi gjyqësor etj. Të gjitha këto shkelje në fund përbëjnë zvarritje e madhe të lëndëve civile, që në disa raste është edhe me dekada.

Një ndër arsyt kryesore të kësaj zvarritje konsiderohet numri i madh i lëndëve civile me të cilat është i ngarkuar sistemi gjyqësor. Në kuptim të këtij fakti që pengon zhvillimin e gjykimeve brenda këtij afati të arsyeshëm, në drejtësinë civile në shkallë të parë që nga viti 2016 nuk ka pasur progres, pasi numri i lëndëve të pazgjdhura të cilat barten vit pas viti vazhdimisht është ngritur. Nga viti 2016 e deri në vitin 2018 njëjtë ka ndodhur edhe në Gjykatën e Apelit, por se ky trend negativ është ndalur në vitin 2019, kur Gjykata e Apelit është përforcuar me gjyqtarë, dhe numri i lëndëve të pazgjdhura që barten vit pas viti ka rënë, derisa ngarkesa me lëndë në Gjykatën Supreme përballon gjykimin e rasteve civile brenda një afati të arsyeshëm kohor. Sa i përket performancës së gjyqtarëve, IKD gjen se shprehur në mesatare, gjyqtarët e gjykatave themelore nuk kanë arritur të zgjidhin lëndë aq sa është e përcaktuar nga KGJK me anë të normës orientuese, derisa këtë normë e kanë arritur gjyqtarët e Gjykatës së Apelit. Por, nëse trajtojmë performancën e gjyqtarëve veç e veç, IKD gjen se ka një disbalanc të theksuar të numrit të lëndëve të zgjidhura në mes të gjyqtarëve.

Por, përballë zvarritjeve të lëndëve civile dhe numrit të madh të lëndëve, IKD ka gjetur se ka raste kur gjyqtarët kanë përfunduar rastet brenda afateve ligjore, përkundër faktit se me ligj, të njëjtat raste nuk janë paraparë si lëndë me prioritet, duke treguar qasje selektive ndaj qytetarëve dhe trajtim të pabarabartë të palëve.

Gjetjet e IKD-së tregojnë se në mesatare të rasteve të monitoruara dhe analizuara, kohëzgjatja e trajtimit të rasteve civile vetëm në shkallë të parë është 1.513 ditë, derisa për trajtimin e një rasti civil nga gjykata e shkallës së dytë, kur edhe konsiderohet se ka përfunduar lënda, është 1.288 ditë. Shprehur në total, i bie se për të përfunduar një rast nga momenti i parashtrimit të padisë e deri në momentin kur vendimi gjyqësor merr formën e prerë, mesatarisht duhet të kalojnë 2.801 ditë, apo rreth 7 vite e 8 muaj.

Kjo kohëzgjatje llogaritet të jetë nëse rasti vendoset në mënyrë meritore nga Gjykata e Apelit, e cila situatë gjatë vitit 2019 nuk është shprehur në 2.386 raste civile të trajtuara nga Gjykata e Apelit, të cilat raste janë kthyer nga kjo gjykata në rigjykim/rivendosje, dhe rastet kanë filluar trajtimin përsëri nga fillimi. Numri i rasteve të kthyera në rigjykim që nga viti 2016 e deri në vitin 2019 është rritur vit pas viti. Por, shprehur në përqindje në mes të numrit të lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve të kthyera në rigjykim/rivendosje, kjo përqindje ka zbritur nga viti 2016 e deri në vitin 2018, derisa IKD gjen se kjo përqindje është ngritur përsëri në vitin 2019.

Sa i përket rasteve karakteristike, IKD gjen se në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës ka ende raste civile në të cilat padia është parashtruar në vitin 1997, por se e njëjta padi ende nuk ka marrë përgjigje definitive. Po ashtu, IKD gjen raste kur lëndët civile janë zvarritur me dekada, për arsye se sistemi gjyqësor nuk ka arritur për vite të tëra që të qartësoj situatën nëse një rast është apo jo “çështje e gjykuar”. Për më tepër, IKD në këtë raport ka evidentuar edhe trajtim diametralisht të ndryshëm nga ana e Gjykatës së Apelit të rastit të Kryetarit të Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, i cili rast ishte trajtuar në procedurë përmbarimore dhe në procedurë penale nga kjo gjykatë.

2. Metodologjia

IKD me qëllim të përpilimit të një raporti sa më gjithëpërfshirës dhe analitik në lidhje me trajtimin e rasteve civile nga sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit. Për draftimin e këtij raporti, IKD ka përdorur dokumente të ndryshme zyrtare përfshi legjislacionin primar dhe sekondar, raporte të KGJK-së, si dhe të dhëna të tjera të siguruar nga institucionet gjyqësore përmes kërkesave për qasje në dokumente publike.

Përpos këtyre dokumenteve, përpilimi i këtij raporti është bazuar në monitorimin e drejtpërdrejtë të performancës së gjyqtarëve në zbatimin e ligjit, politikave dhe planeve të veprimit për trajtimin e rasteve civile në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës. Për të dhënat e grumbulluara gjatë procesit të monitorimit të sistemit të drejtësisë, IKD përditëson për publikun Platformën e Monitorimit të Gjyqësorit (<https://ejudiciary.org/>).

IKD bazuar në obligimet ligjore dhe planet e veprimit ka krijuar indikatorë të qartë për matjen e progresit dhe regresit të sistemit gjyqësor. IKD gjatë vitit 2019 ka monitoruar gjithsej 1,715 seanca të natyrës civile në të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës. Ky raport përfshin monitorimin e rasteve civile në të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës, përfshirë këtu edhe degët e gjykatave themelore. Për të njëjtën periudhë kohore, raporti i bënë një trajtim të veçantë disa prej rasteve më karakteristike civile në sistemin e drejtësisë.

Sa i përket rasteve civile në sistemin gjyqësor, IKD në këtë raport ka analizuar ngarkesën me lëndë të departamenteve të përgjithshme – divizioneve civile, trendin e efikasitetit, mënyrën e zgjidhjes së lëndëve, performancën individuale të gjyqtarëve etj. Për të gjitha këto, IKD në këtë raport ka dhënë vlerësimet dhe rekomandimet konkrete se si duhet të përmirësohet efikasiteti dhe efektiviteti në trajtimin e këtyre rasteve.

Në këtë raport, IKD ka analizuar gjetjet kryesore nga monitorimi sistematik i rasteve civile në sistemin gjyqësor, derisa në annexin 1 të këtij raporti do të trajtohen edhe raste të përzgjedhura të proceseve gjyqësore civile.

Pas kësaj, para publikimit të këtij raporti, ky raport është ndarë me të gjithë Kryetarët e Gjykatave dhe Kryesuesin e KGJK-së, nga të cilët ka kërkuar komente përkitazi me gjetjet e këtij raporti. Komentet e pranuar, janë pjesë e këtij raporti.

3. Korniza ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka materializuar standardet më të larta në lidhje me garancinë dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Kushtetuta njihet si akti më i lartë juridik i vendit, në harmoni me të cilin duhet të jenë të gjitha aktet e tjera ligjore e nënligjore. Në kuadër të Kushtetutës janë materializuar edhe parimet që ndërtojnë drejtësinë në rastet juridiko-civile.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtën e mjeteve juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative që shkelin të drejtat ose interesat e qytetarëve të saj. Kushtetuta gjithashtu ka vendosur si kriter se mjetet juridike, përveç që duhet të jenë në dispozicion, gjithashtu duhet të jenë efektive.

Po ashtu, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar se *“E drejta e pronës është e garantuar”*¹. Sa i përket rregullimit të llojeve të pronës, këtë çështje Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka lënë në kompetencë të ligjit².

Republika e Kosovës në faqen e parë të Kushtetutës së saj ka paraparë se autoriteti i saj shtetëror do të ushtrohet dhe bazohet në respektim të të drejtave të njeriut, sidomos atyre të drejtave dhe lirive themelore të pranuar ndërkombëtarisht.

Duke u nisur nga parimi i mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, i cili parim është parim bazë sipas të cilat Republika e Kosovës e ushtron pushtetin e saj shtetëror, Kushtetuta e Republikës së Kosovës në rendin juridik kosovar ka inkorporuar dokumente të rëndësishme ndërkombëtare me qëllim të respektimit të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ndër më kryesoret është edhe KEDNj, e cila ka epërsi ndaj ligjeve tjera të Republikës së Kosovës në rast të konfliktit ligjor³.

Sa i përket të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si pikë reference për interpretimin e këtyre të drejtave dhe lirive, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përkatësisht, neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

¹ Po aty, neni 46

² Po aty,

³ *Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese”. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 22*

Në këtë drejtim, neni 6 i KEDNj-së përcakton se “Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”.

Krahas dispozitës në KEDNj, dokument ky drejt për së drejti i zbatueshëm në rendin juridik kosovar, e cila garanton që gjykimi të jetë i zhvilluar brenda një kohe të arsyeshme, ky standard është inkorporuar edhe në vetë tekstin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me ç’rast është nënvizuar se “Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj, e cila dispozitë rrumbollakson të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm”⁴.

Sa i përket rasteve gjyqësore të natyrës civile, të njohura ndryshe si kontestet juridiko-civile, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 03/L-199 për Gjykatat përcaktohen organet kompetente gjyqësore për trajtimin e këtyre lëndëve. Duke ruajtur strukturën e njëjte organizative sa i përket këtyre rasteve, ky ligj është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat.

Sipas Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, sistemi i gjykatave i Republikës së Kosovës përbëhet nga: Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, derisa sipas këtij ligji, degët e gjykatave themelohen brenda territorit të gjykatave themelore⁵.

Ky ligj përcakton se “Departamenti i Përgjithshëm, që vepron në selinë e secilës Gjykatë Themelore, si dhe në secilën degë të Gjykatës Themelore”⁶ dhe se “Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore gjykon në shkallë të parë të gjitha çështjet, përveç nëse kjo është në kompetencë e një Departamenti tjetër të Gjykatës Themelore”⁷.

Në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm funksionojnë edhe tri (3) divizione, përkatësisht Divizioni Penal, Divizioni për Kundërvajtje dhe Divizioni Civil.

Ky i fundit, është objekt i trajtimit të këtij raporti. Po ashtu, në të njëjtën mënyrë, ky departament funksionon edhe në kuadër të Gjykatës së Apelit, derisa në Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, gjyqtarët nuk janë të ndarë në departamente sipas natyrës së lëndëve që trajtohen.

Sa i përket rasteve civile, sistemi juridik i Republikës së Kosovës ka një bazë ligjore pothuajse të konsoliduar, e cila në ligj garanton realizimin e të drejtave të qytetarëve në proceset gjyqësore të karakterit juridiko-civil. Në këtë drejtim, si ligje bazike për këto raste janë Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji mbi Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore dhe Ligji për Procedurën Kontestimore. Aktualisht, Ministria e Drejtësisë ka proceduar në Kuvendin e

⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 31.2.

⁵ Ligji Nr.06/L-054 për Gjykatat. Neni 8

⁶ Po aty. Neni 13.1.1.5.

⁷ Po aty. Neni 20.

Republikës së Kosovës, Projekt-Kodin Civil, por se i njëjti është nuk është miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Me qëllim të zgjidhjes më të shpejtë të rasteve në njërën anë dhe shkarkimit me lëndë të gjykatave në anën tjetër, në Republikën e Kosovës funksionojnë edhe profesionet e lira që japin kontribut në këtë aspekt, siç janë noteria, përmbaruesi privat dhe ndërmjetësuesi.

3.1. Standardet e GjEDNj-së mbi procedurat gjyqësore në çështjet civile

Nisur nga rëndësia e jurisprudencës së GjEDNj-së dhe standardeve të kësaj gjykate në rendin juridik kosovar, në kuptim të temës së këtij raporti, është e rëndësishme të theksohen disa vendime gjyqësore nga jurisprudenca e GjEDNj-it. Përgjatë dekadave, kjo gjykatë duke interpretuar KEDNj-në, ka vendosur standarde të rëndësishme.

Fillimisht, sa i përket aspektit gjyqësor procedural, një ndër parimet kryesore të KEDNj-it është mjeti efektiv juridik. Në këtë kuptim, KEDNj përcakton se:

Neni 13

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

Në kuptim të mjetit juridik sipas kësaj dispozite të KEDNj-it, GjEDNj në rastet “McFarlane kundër Irlandës” dhe “Riccardi Pizzati kundër Italisë”, ka nënvizuar se një mjet juridik është efektiv vetëm nëse është i arritshëm dhe meritord,⁸ derisa në rastet “El-Masri kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (Aktualisht Maqedonia e Veriut)” dhe “Kudła kundër Polonisë”, kjo Gjykatë ka potencuar se efektshmëria e një mjeti juridik duhet të jetë e zbatueshme si në praktikë, ashtu edhe në rregullimin ligjor⁹.

Ndërsa, në rastin “Mikulic kundër Kroacisë”, theksohet se *"Shtetet Kontraktuese duhet të organizojnë sistemet e tyre juridike në një mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të mund të garantojnë të drejtën e secilit për të marrë një vendim përfundimtar për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet civile brenda një kohe të arsyeshme"*¹⁰

⁸ Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti McFarlane kundër Irlandës. Aktgjykim. Strasburg. 10 shtator 2010. Paragrafi 114.; Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Riccardi Pizzati kundër Italisë. Aktgjykim. Strasburg. 29 mars 2006. Paragrafi 38.

⁹ Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti El-Masri kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Aktgjykim. Strasburg. 13 dhjetor 2012. Paragrafi 255; Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Kudła kundër Polonisë. Aktgjykim. Strasburg. 26 tetor 2000. Paragrafi 152

¹⁰ Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Mikulic kundër Kroacisë. Aktgjykim. Strasburg. 4 shtator 2002. paragrafi 45.

Po ashtu, GjEDNJ në rastin “Peceve kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (aktualisht Maqedonia e Veriut)” ka theksuar se autoritetet shtetërore e kanë për obligim pozitiv që të organizojnë një sistem efikas për zbatim të vendimeve në kuptimin ligjor dhe praktik dhe të sigurojnë që zbatimi i tyre të bëhet pa vonesa të panevojshme¹¹.

Përcaktimi dhe nocioni i “*të drejtave dhe detyrimeve civile*” që parashihet në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ, është i gjerë dhe përfshin proceset gjyqësore të cilat përcaktojnë të drejta dhe detyrime civile dhe si rrjedhojë sipas vendimeve të GJEDNJ, neni 6 mbulon vetëm proceset gjyqësore të cilat kanë të bëjnë me të drejta dhe detyrime. Në çështjen “Ringeisen kundër Austrisë”, Gjykata Evropiane u shpreh se: “*të gjitha proceset gjyqësore, rezultati i të cilave është vendimtar për të drejtat dhe detyrimet private përbëjnë përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile*”. Në të njëjtën çështje, Gjykata vendosi që “*karakteri i legjislacionit, i cili rregullon mënyrën sesi përcaktohet çështja dhe organin e ngarkuar me juridiksion mbi gjykimin e çështjes për pasojë, ka pak ndikim*”.¹² Sipas përcaktimit të vendimit në fjalë vërehet se të drejtat dhe detyrimet civile janë autonome dhe nuk mund të interpretohen vetëm sipas të drejtës vendase dhe nuk është vendimtare vetëm e drejta vendase në përcaktimin e një të drejte civile.

Neni 6 i KEDNJ-it kërkon që proceset të zhvillohen brenda “*një afati të arsyeshëm*”. Në kërkesën që gjykimi i çështjeve të bëhet brenda “*një afati të arsyeshëm*”, GjEDNJ në rastin “H kundër Francës” vë theksin tek rëndësia e administrimit të drejtësisë pa vonesa, e kundërta e së cilës mund të kërcënojnë efektshmërinë dhe besueshmërinë e saj¹³.

Si rrjedhojë e garantimit të së drejtës së qytetarëve për një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, GjEDNJ në rastin Stogmuller kundër Austrisë ka përcaktuar se e drejta e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, garanton dhe mbron të gjitha palët në proces gjyqësor nga vonesat e gjata procedurale¹⁴.

Neni 6 par.1 i KEDNJ sipas aktgjykimit të GjEDNJ në rastin “Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë” ka përcaktuar se “*kërkesat e nenit 6 po ashtu kërkojnë nga shtetet që të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të atillë që autoritetet kompetente të përmbushin kërkesat e nenit 6, duke përfshirë edhe detyrimin për të dëgjuar çështjet brenda një kohë të arsyeshme dhe nëse është e nevojshme t’i bashkojnë procedurat , t’i pezullojnë ato, apo edhe të hedhin poshtë vendimet për procedurat e reja*”¹⁵.

Rrjedhja e një procesi gjyqësor civil brenda respektimit të kushtit të afatit të arsyeshëm është një digë e fortë për krijimin e sigurisë juridike të palëve në procedurë nga arbitrariteti i gjykatave. GjEDNJ dhe KEDNJ në kontekst të gjykimit në “*kohë të arsyeshëm*”, nuk ka përcaktuar në mënyrë specifike se sa mund të jetë një kohëzgjatja, e cila mund të cenojë të

¹¹ Peceve kunder Ish-Republikes Jugosllave te Maqedonise, te 6 nentorit 2008, Ankimi nr. 21839/03; s

¹² Ringeisen kundër Austrisë, GJEDNJ, Aktgjykim 16 korrik 1971, nr 2615/65

¹³ H kundër Francë, 24 Tetor 1989, para.58.

¹⁴ Stögmüller kundër Austrisë, 10 Nëntor 1969, para. 5.

¹⁵ Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë GJEDNJ

drejtën për gjykim në kohë të arsyeshme, por konstatimin e shkeljes së kësaj të drejte GjEDNJ e merr në konsideratë dhe vlerëson duke u bazuar në rrethanat e rastit konkret.

Për të përcaktuar nëse në një rast civil kemi të bëjmë me kohëzgjatje të procedurave civile GjEDNJ ka paraparë edhe kritere të cilat janë manifestuar në rastin “Tomaziv kundër Sllovenisë”, në të cilin aktgjykim përcaktohet se kohëzgjatja e procedurës civile vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit, duke përfshirë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e parashtruesit të kërkesës, sjelljen e autoriteteve relevante dhe rreziku për parashtruesin e kërkesës.

Në rastin “Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë”, GjEDNJ ka përcaktuar se llogaritja e procesit civil fillon në momentin kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesën e palëve për të vendosjen e një të drejte apo interesi të ligjshëm. GjEDNJ në rastin “Koing kundër Gjermanisë” ka nënvizuar se për të vlerësuar arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore, merret në vlerësim i gjithë procesi në tërësinë e tij.

Megjithatë, GjEDNJ ka theksuar se në disa raste kur çështjet civile janë komplekse, atëherë mund të arsyetohen edhe procedurat e gjata.¹⁶

GJEDNJ në një rast tjetër ka nënvizuar se shteti është përgjegjës për vonesat në procedura, kur ato shkaktohen nga sjellja e tij¹⁷. Megjithatë, akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk çon në përgjegjësinë e shtetit, me kusht që ky i fundit të ketë ndërmarrë veprime që synojnë përmirësimin e situatës në mënyrë të arsyeshme¹⁸.

Kurse vonesat të cilat vijnë si rezultat i grumbullimit afatgjatë të çështjeve të trashëguara si të pakryera në gjykata, kombinuar me mos marrjen e masave për të korigjuar situata të tilla, në rastin Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës nga GjEDNJ janë konsideruar shkelje të KEDNJ-së. Të njëjtin qëndrim GjEDNJ e ka shprehur edhe në rastin “Probstmeier kundër Gjermanisë”, ku ka konstatuar se mbingarkesa kronike e gjykatave nuk mund të justifikojë tejzgjatjen e proceseve¹⁹.

Sjellja e palëve gjatë procesit civil përbën një fakt objektiv të cilin e merr parasysh GjEDNJ gjatë vlerësimit nëse është kaluar apo jo koha e arsyeshme sipas kërkesave të nenit 6 të KEDN²⁰.

GjEDNJ në një vendim ka thënë “*Duhet të theksohet më tej se rishqyrtimi i përsëritur i një çështjeje të vetme pas kthimit për rigjykim, në vetvete, mund të zbulojë një mangësi serioze në sistemin gjyqësor të një shteti të caktuar*”²¹.

Po ashtu, GjEDNJ në çështjen “Marini kundër Shqipërisë” u shpreh se “*Gjykata vëren se çështja është kthyer disa herë për rishqyrtim. Ajo vë në dukje se në çështje të ngjashme, kur*

¹⁶ Tierce kundër San Marino, çështja nr. 69700/01, 17 qershor 2003, § 31.

¹⁷ Buchholz vs. Germany.

¹⁸ (Buchholz kundër Gjermanisë, GJEDNJ, § 51).

¹⁹ Probstmeier kundër Gjermanisë, § 64.

²⁰ Erkner and Hofauer vs Austria § 68.

²¹ Pavlyulynets kundër Ukrainës”, nr. 70767/01, § 51, 6 shtator 2005).

te jzgjatja e proceseve shkaktohet në masë të madhe nga rishqyrtimi disa herë i të njëjtës çështje, ajo ka konstatuar se, për shkak se kthimi për rigjykim ka ardhur si rezultat i gabimeve të kryera nga gjykatat më të ulëta, përsëritja e urdhrave të tillë brenda të njëjtit grup procesesh nxjerr në pah një mangësi serioze në sistemin gjyqësor". Po ashtu, Gjykata shprehet se përmes dhënies së disa vendimeve kontradiktore në nivelet e juridiksionit, autoritetet shqiptare demonstrojnë mangësi të sistemit gjyqësor për të cilin ato janë përgjegjëse²²

Në çështjen "Topallaj kundër Shqipërisë" dhe "Luli & të tjerët kundër Shqipërisë" GjEDNj u shpreh se gjykatat e brendshme kanë kontribuar për tejzgjatjen e proceseve duke e kthyer çështjen për rishqyrtim në mënyrë të përsëritur tek gjykatat më të ulëta. Në këtë drejtim, u shpreh Gjykata, e drejta për shqyrtimin e një çështjeje brenda një kohe të arsyeshme nuk ka kuptim nëse gjykatat e brendshme e gjykojnë të njëjtën çështje disa herë duke e kaluar për gjykim nga një gjykatë në tjetrën, edhe pse në fund kohëzgjatja e proceseve në secilin rast nuk duket veçanërisht e tepruar. Gjykata rithekson që është e detyrueshme për shtetet përgjegjëse që ato t'i organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të mund të përmbushin kërkesat e nenit 6 të Konventës, përfshirë edhe detyrimin për gjykimin e çështjeve brenda një kohe të arsyeshme.

Ndërsa sa i përket kriterit të fundit, rrezikun e palës në proces gjyqësor civil, sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, disa çështje për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshtypim të posaçëm të trajtimit të rastit. Në rastin "Niederböster kundër Gjermanisë", GjEDNj konstaton se duhet të merret parasysh edhe kriteri se çfarë përbën rrezik për pozitën e ankuesit në procesin gjyqësor. Prandaj është thelbësore që çështjet që kanë të bëjnë me kujdestarinë, të trajtohen me shpejtësi të veçantë.²³

Çështja e kohëzgjatjes së procedurave civile mund të trajtohet edhe nga aspekti i mungesës së mjeteve juridike efektive për t'u mbrojtur nga zvarritja e procedurës civile. Kjo dispozitë e cila është e mishëruar edhe në sistemin tonë juridik, kërkon nga shteti që tu sigurojë qytetarëve mjete juridike të cilat në teori dhe praktikë janë efektive për shkeljen e të drejtave të garantuara në Konventë. Në çështjen "Klass kundër Gjermanisë", GjEDNj ka përcaktuar se neni 13 parashikon se çdo individ, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Konventë, duhet të ketë në dispozicion një mjet efektiv juridik për t'u mbrojtur përpara një autoriteti vendas, edhe kur "shkelja kryhet" nga persona që mbajnë funksion zyrtar. Sipas pikëpamjes së Gjykatës, neni 13 kërkon që kur një individ e konsideron veten të cenuar nga një masë që pretendohet se është në kundërshtim me Konventën, ai duhet të ketë një mjet juridik që mund ta ushtruar përpara një autoriteti vendas, në mënyrë që: 1) të merret një vendim mbi kërkesën e tij dhe 2) nëse kërkesa është e drejtë, të marrë dëmshpërblim për dëmin e pësuar. Prandaj, neni 13 duhet të interpretohet si garanci për "mjet ligjor efektiv para një autoriteti vendas" ndaj kujtdo që pretendon shkelje të të drejtave dhe lirive të tij sipas Konventës.

Në çështjen "Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar", GjEDNj nënvizon se "Gjykata rithekson që Neni 13 i Konventës garanton disponueshmërinë në nivel vendas të një mjeti juridik për të

²² GjEDNj në çështjen "Marini kundër Shqipërisë".

²³ Niederböster kundër Gjermanisë, § 39.

zbatuar thelbin e të drejtave dhe lirive të Konventës, në çfarëdo mënyre që ato të sigurohen në rendin juridik të brendshëm. Megjithatë, mjete juridik i kërkuar nga Neni 13 duhet të jetë "efektiv", si në praktikë dhe në ligj. Veçanërisht, përdorimi i tij nuk duhet të pengohet në mënyrë të pajustificuar nga veprimet ose mosveprimet e autoriteteve të shtetit të paditur”.

3.2.Përgjegjësia ligjore e Këshillit Gjyqësor për sigurimin e një sistemi të drejtë dhe objektiv

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) është institucion kushtetutes, i cili ka për qëllim që sistemi gjyqësor i Kosovës të jetë i pavarur, profesional dhe i paanshëm. Përcaktimi i këtij detyrimi është i shprehur në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. KGJK është përgjegjës për sigurimin e vlerësimeve të rregullta periodike mbi ngarkesën e lëndëve të gjykatave ashtu që të sigurohet funksionimi efikas në gjykatat e Republikës së Kosovës.

Në bazë të Ligjit mbi KGJK-në, ky institucion ka për mandat ligjor sigurimin dhe vlerësimin e rregullt periodik mbi ngarkesën e lëndëve, në mënyrë që të sigurohet funksionimi efikas i gjykatave. KGJK po ashtu ka për kompetencë administrimin e gjyqësorit dhe inspektimin e tij, derisa disiplinimi dhe vlerësimi i performancës së prokurorëve është në kompetencë ekskluzive të këtij Këshilli.

KGJK po ashtu ka miratuar Planin Strategjik të Gjyqësorit për periudhën kohore 2014-2019. Ky Plan Strategjik përbëhet prej pesë shtyllave kryesore të cilat janë, krijimi i besimit dhe mbështetjes, avancimi i administrimit të drejtësisë, shtimi i qasjes në drejtësi dhe në shërbim për qytetarë, promovimi i kompetencës, i profesionalizmit dhe mirësjelljes, përmisimi i objekteve dhe teknologjisë së gjykatave.

Në objektivin strategjik 2.4.1 është përcaktuar se Këshilli Gjyqësor gjatë kësaj periudhe do të eliminojë dhe do t'i miratojë procedurat për t'iu shmangur grumbullimit të lëndëve në të ardhmen:

“Një numër i madh i lëndëve të grumbulluara ka ekzistuar qysh kur sistemi gjyqësor është organizuar për republikën e re të Kosovës. Përpjekjet që janë bërë për ta zgjidhur çështjen e lëndëve të grumbulluara sipas strategjisë së parë për reduktimin e lëndëve të vjetra nuk kanë qenë të kënaqshme. KGJK-ja e ka miratuar strategjinë të dytë kombëtare për reduktimin e lëndëve të vjetra, e cila inkorporohet përmes kësaj reference. Mjetet kryesore tani ekzistojnë në formë të të dhënave të një baze të të dhënave të besueshme, e cila, me planet që po hartohen tani në çdo gjykatë themelore, do të sigurojë proces gjithëpërfshirës me përgjegjësi lokale dhe monitorim nga Sekretariati, për ta reduktuar numrin e lëndëve të vjetra. Një fokus i veçantë i planeve në secilën gjykatë do të jetë tek reduktimi i lëndëve të përmbarrimit përmes metodave më efikase të marrjes me këto lëndë. Tani ekzistojnë mjete shitesë për t'i bartur gjyqtarët aty ku më së shumti ka nevojë” - thuhet në objektivin 2.4.1. të këtij plani strategjik.

4. Ngarkesa me lëndë civile në Gjykatat Themelore dhe degët e saj në vitin 2019

Bazuar në statistikat të publikuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), rezulton se shtatë (7) gjykatat themelore në Republikën e Kosovës, përfshirë edhe degët e tyre, në vitin 2019 kanë pasur në punë gjithsej 68.261 lëndë civile. Nga ky numër i lëndëve, gjykatat themelore kanë trashëguar nga viti paraprak gjithsej 44.213 lëndë civile, derisa gjatë vitit 2019, gjykatat themelore së bashku me degët e tyre kanë pranuar edhe 24.048 lëndë të reja.


Ndërsa, prej këtyre lëndëve, gjykatat themelore dhe degët e gjykatave në total kanë zgjidhur 20.335 lëndë civile, ndërsa të pazgjidhura në fund të vitit 2019, kanë mbetur 47.926 lëndë civile.

Bazuar në këto të dhëna të KGJK-së, gjykatat themelore së bashku me degët e tyre, gjatë vitit 2019 nuk kanë arritur të zgjidhin lëndë aq sa edhe kanë pranuar. Përkundrazi, numri i lëndëve të zgjidhura gjatë vitit 2019 është më i ulët se sa numri i lëndëve të pranuar. Rrjedhimisht, në fund të vitit 2019 është ngritur numri i lëndëve të pazgjidhura të cilat barten vit pas viti. Përkatësisht, përderisa në fund të vitit 2018 në gjykatat themelore dhe degët e tyre kishin mbetur të pazgjidhura gjithsej 44.213 lëndë, në fund të vitit 2019 ky numër është ngritur për 3.713 lëndë. Përkatësisht, në fund të vitit 2019, në gjykatat themelore dhe degët e tyre kanë mbetur të pazgjidhura gjithsej 47.926 lëndë.

Për më tepër nëse krahasojmë numrin e lëndëve të pazgjidhura me vitet paraprake prej 2016-2018, padyshim se viti 2019 merr primatin e rritjes më të madhe të numrit të lëndëve civile të pazgjidhura.

Përderisa në fund të vitit 2016 kanë mbetur të pazgjidhura 40.538 lëndë, në vitin 2017 ky numër është rritur për 829 lëndë, përkatësisht në 41.367 lëndë të pazgjidhura në fund të vitit 2017. Rritja e numrit të lëndëve të pazgjidhura të cilat barten vit pas viti ka vazhduar edhe në vitin 2018, pasi gjatë këtij viti, numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2018 është rritur edhe për 2.846 lëndë civile. Përkatësisht, në fund të vitit 2018, në të gjitha GjTh-të, përfshirë edhe degët e tyre, kanë mbetur të pazgjidhura gjithsej 44.213 lëndë civile. Kurse në për periudhën raportuese të vitit 2019 shihet se numri i lëndëve të pazgjidhura ka arritur në 47.926 lëndë, përkatësisht 3.713 lëndë më shumë.

Trendi i rritjes së numrit të lëndëve civile të pazgjidhura 2016-2019



Grafika 1: Trendi i rritjes së numrit të lëndëve civile të pazgjidhura 2016-2019.


Për të vlerësuar objektivisht rritjen e trendit të lëndëve të pazgjidhura të cilat barten vit pas viti, IKD ka analizuar ngarkesën e gjykatave themelore me lëndë të pranuar në raport me lëndët që kanë zgjidhur gjatë viteve raportuese 2016-2019.

Në këtë drejtim, IKD gjen se përgjatë këtyre viteve, statistikat shfaqin rritje të vazhdueshme të numrit të lëndëve të pranuar, ashtu që derisa në vitin 2016 në të gjitha GjTh-të janë pranuar 15.522 lëndë, ky numër është rritur për 2.218 lëndë në vitin 2017. Përkatësisht, gjatë vitit 2017, GjTh-të dhe degët e tyre kanë pranuar gjithsej 17.740 lëndë të reja. Nisur nga fakti se gjatë vitit 2017 numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit është ngritur për 829 lëndë, shihet se kjo ngritje ka qenë rezultat i ngritjes së numrit të lëndëve të pranuar.

Por, ky përfundim nuk është kështu edhe sa i përket vitit 2018. Kjo pasi gjatë këtij viti, numri i lëndëve të pranuar në raport me numrin e lëndëve të pranuar në vitin paraprak është ngritur edhe për 1.869 lëndë të reja (19.609 lëndë të pranuar), derisa numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit është ngritur për 2.846 lëndë.

Kurse në vitin 2019 në të gjithë GjTH- janë pranuar 24.048 lëndë civile, respektivisht 4.439 lëndë civile më shumë se vitin 2018. Nisur nga fakti se gjatë vitit 2019 numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit është ngritur për 3.713 lëndë, shihet se edhe në vitin 2019, arsye e ngritjes së këtij numri ka qenë ngritja e numrit të lëndëve të pranuar.

Në total, nëse e shikojmë numrin e lëndëve të zgjidhura nga GjTh-të dhe degët e tyre në raport me lëndët civile të cilat kanë qenë në punë gjatë vitit 2019, rezulton se GjTh-të dhe degët e tyre kanë zgjidhur 29.7 përqind të lëndëve të cilat gjykatat i kanë pasur në punë.



Grafika 2: Përqindja e numrit të lëndëve të zgjidhura dhe të pazgjidhura gjatë vitit 2019.

Edhe kryesuesi i KGJK-së, Skender Çoçaj, thotë se ngritja e numrit të lëndëve të pazgjidhura ka ardhur si rezultat i ngritjes së numrit të lëndëve të pranuar:

“Gjykatat kanë zgjedhur numër më të madh të lëndëve në krahasim me tre (3) vitet paraprake, ndërsa sa i përket numrit të lëndëve të pazgjidhura në total, Këshilli Gjyqësor i Kosovës çdo vit i publikon raportet statistikore vjetore në portalin zyrtar të tij, dhe nga këto raporte shihet se ka progres të madh në zgjidhjen e lëndëve në vitin 2019, mirëpo rritja e numrit të lëndëve civile për vitin 2019, po ashtu lidhet me rritjen e trendit të lëndëve nga marrëdhënia e punës, konkretisht kontesteve për paga jubilarë dhe shujta, me ç’rast ka pasur numër enorm të padive të parashtruara në gjykata, për shkak të mos kompensimit të tyre nga ana e punëdhënësit, duke i ngarkuar edhe më tepër departamentet e përgjithshme - divizionet civile me lëndë të kësaj natyre, ndërsa reduktimi i këtyre lëndëve, normalisht se varet nga shumë faktorë, për të cilat vazhdimisht po punon Këshilli, ku një prej tyre është rritja e numrit të gjyqtarëve dhe stafit mbështetës. Lidhur me rritjen e numrin të gjyqtarëve dhe raportit të lëndëve të pazgjidhura, siç jeni në dijeni, gjyqtarët me rastin e emërimit të tyre fillimisht ju nënshtrohen trajnimeve obligative të parapara me legjislacionin në fuqi, pastaj edhe fillon ndarja e lëndëve për ta, ku në disa raste këta gjyqtarë vetëm i plotësojnë vendet e gjyqtarëve të pensionuar ose të avancuar, dhe normalisht që këtu ndikon edhe bartja e lëndëve nga gjyqtarët paraprak, por, Këshilli vazhdimisht po e monitoron këtë situatë. Po ashtu, Këshilli ka ndër marr veprime tjera në këtë drejtim duke rekrutuar edhe staf mbështetës për gjyqtar, me synim që të rritet numri i stafit profesional, përkatësisht bashkëpunëtoreve profesional, ndonëse nuk është numri i

mjaftuar, por që e njëjta nuk varet nga KGJK, por nga buxheti”, thuhet në përgjigjen e Kryesuesit Çoçaj²⁴.

Në anën tjetër, prej gjithë gjykatave themelore në nivel vendi, Gjykata Themelore në Prishtinë së bashku me degët e saj në Podujevë, Graçanicë, Lipjan dhe Gillogoc, bazuar në statistikat zyrtare të KGJK-së është GjTh më e ngarkuara më lëndë civile, ku gjatë vitit 2019, GjTh Prishtinë së bashku me degët e saj ka pasur në punë 27.887 lëndë civile. Prej tyre ka zgjidhur 6.498 lëndë apo 23.30 % të lëndëve të cilat i ka pasur në punë. Të pazgjidhura kanë mbetur 21,389 lëndë, duke e rritur numrin e lëndëve të pazgjidhura për 1.191 lëndë në krahasim me numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2018. Në raport me numrin e lëndëve zgjidhura dhe të pranuar shihet se GjTh në Prishtinë së bashku me degët e saj nuk ka arritur zgjidhë më shumë lëndë sesa janë pranuar për faktin se gjatë vitit 2019 janë pranuar 7.689 lëndë ndërsa janë zgjidhur 6.498 lëndë.

Gjykata Themelore në Gjilan së bashku me degët e saj në Kamenicë, Viti, Novobërdë, gjatë vitit 2019 ka qenë e ngarkuar me 6.538 lëndë civile. Prej tyre ka zgjidhur 2.078 lëndë, apo 31.78% të lëndëve që ka pasur në punë. Të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese kanë mbetur 4.460 lëndë civile, duke e rritur numrin e lëndëve të pazgjidhura për 256 lëndë, në krahasim me numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2018. Në raport me numrin e lëndëve të zgjidhura dhe të pranuar gjatë vitit 2019 GjTh Gjilan së bashku me degët e saj, nuk kanë arritur të zgjidhin më shumë lëndë sesa kanë pranuar, për faktin se janë pranuar 2.334 lëndë ndërsa janë zgjidhur 2.078 lëndë.

Gjykata Themelore në Prizren së bashku me degët e saj në Dragash dhe Suharekë gjatë vitit 2019 ka qenë e ngarkuar me 6.510 lëndë civile. Prej tyre ka zgjidhur 2.394 lëndë apo 36.7% të lëndëve që ka pasur në punë. Të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese kanë mbetur 4.116 lëndë civile, duke e rritur numrin e lëndëve të pazgjidhura për 661 lëndë më shumë në krahasim me numrin e lëndëve të pazgjidhura të vitit 2018. Në raport me numrin e lëndëve të zgjidhura dhe të pranuar gjatë vitit 2019, shihet se GjTh Prizren së bashku me degët e saj, nuk kanë zgjidhur më shumë lëndë sesa kanë pranuar, për faktin se janë pranuar 3.055 lëndë ndërsa janë zgjidhur 2.394 lëndë.

Gjykata Themelore në Mitrovicë së bashku me degët e saj në Vushtrri, Skenderaj dhe Zubin Potok dhe Leposaviq, për vitin 2019 ka qenë e ngarkuar me 8.041 lëndë civile. Prej tyre ka zgjidhur 2.338 apo 29% të lëndëve që i ka pasur në punë. Të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese kanë mbetur 5.703 lëndë civile, duke e rritur numrin e lëndëve të pazgjidhura për 667 lëndë më shumë, në krahasim me numrin e lëndëve të pazgjidhura të vitit 2018. Në raport me numrin e lëndëve të zgjidhura dhe të pranuar gjatë vitit 2019, shihet se GTh në Mitrovicë së bashku me degët e saj, nuk kanë zgjidhur më shumë lëndë sesa kanë pranuar, për faktin se janë pranuar 3.005 lëndë ndërsa janë zgjidhur 2.338 lëndë.

Gjykata Themelore në Gjakovë së bashku me degët e saj në Rahovec dhe Malishevë, gjatë vitit 2019 ka qenë e ngarkuar me 5.929 lëndë civile. Prej tyre ka zgjidhur 1.913 lëndë apo 32.2% të

²⁴ Përgjigje e Kryesuesit të KGJK-së, Skender Çoçaj për IKD-në. 22 tetor 2020.

lëndëve që i kanë pasur në punë. Të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese kanë mbetur 4.016 lëndë civile, duke e rritur numrin e lëndëve të pazgjidhura për 528 lëndë më shumë, në krahasim me numrin e lëndëve të pazgjidhura të vitit 2018. Në raport me numrin e lëndëve të zgjidhura dhe të pranuar gjatë vitit 2019, shihet se GjTh në Gjakovë së bashku me degët e saj, nuk kanë arritur të zgjidhin më shumë lëndë sesa kanë pranuar për faktin se janë pranuar 2.441 lëndë ndërsa janë zgjidhur 1.913 lëndë.

Gjykata Themelore në Pejë së bashku me degët e saj në Klinë, Deçan dhe Istog, gjatë vitit 2019 kanë pasur në punë 8.754 lëndë civile. Prej tyre kanë zgjidhur 2.963 apo 33.8 % të lëndëve që i kanë pasur në punë. Të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese kanë mbetur 5.791 lëndë, duke e rritur numrin e lëndëve të pazgjidhura për 468 lëndë më shumë, në krahasim me numrin e lëndëve të pazgjidhura të vitit 2018. Në raport me numrin e lëndëve të zgjidhura dhe të pranuar gjatë vitit 2019, shihet se GjTh në Pejë së bashku me degët e saj, nuk kanë arritur të zgjidhin më shumë lëndë sesa kanë pranuar për faktin se janë pranuar 3.431 lëndë ndërsa janë zgjidhur 2.963 lëndë.

Gjykata Themelore në Ferizaj së bashku me degët e saj në Kaçanik dhe Shtërpçë, në vitin 2019 kanë pasur në punë 4.602 lëndë civile. Prej tyre kanë zgjidhur 2.151 lëndë civile apo 46.7% të lëndëve që i kanë pasur në punë. Të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese kanë mbetur 2.451 lëndë, duke e ulur numrin e lëndëve të pazgjidhura për 58 lëndë, në krahasim me numrin e lëndëve të pazgjidhura të vitit 2018. Në raport me numrin e lëndëve të zgjidhura dhe të pranuar gjatë vitit 2019, shihet se GjTh në Ferizaj së bashku me degët e saj, kanë zgjidhur më shumë lëndë sesa kanë pranuar për faktin se janë pranuar 2.093 lëndë ndërsa janë zgjidhur 2.151 lëndë civile.

Pra, nga këto të dhënat shihet se në mesin e të gjitha gjykatave themelore, përqindjen më të ulët të numrit të lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve në punë e ka Gjykata Themelore në Prishtinë, derisa kjo përqindjen më të lartë në këtë rast e ka Gjykata Themelore në Ferizaj.

4.1.Performanca e zgjidhjes së rasteve civile në Gjykatat Themelore gjatë vitit 2019

Bazuar në të dhënat zyrtare të KGJK-së, Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2019 kanë zgjidhur 20.335 lëndë civile përderisa kanë pranuar edhe 24.048 lëndë të reja. Në total, gjykatat themelore kanë qenë të ngarkuara me 68.261 lëndë civile.

Siç u tha edhe më lartë, nga këto statistika zyrtare të KGJK-së shihet se gjyqtarët gjatë vitit 2019 nuk kanë arritur të zgjidhin më shumë lëndë sesa kanë pranuar dhe rrjedhimisht numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese është rritur për 3.713 lëndë. Kjo shifër e rritjes së numrit të lëndëve të pazgjidhura është më e larta në krahasim me tre vitet paraprake.

Totali i lëndëve në punë prej 68.261 lëndë civile kanë qenë të shpërndara tek 99 gjyqtar të gjykatave themelore të cilët gjykojnë në divizionet civile të GjTh-ve dhe degët e tyre.

Në këtë mënyrë, në mesatare i bie se gjatë vitit 2019 secili gjyqtar/e ka qenë i/e ngarkuar me nga 689.5 lëndë civile.

Ndërsa gjatë vitit 2019, mesatarisht, secili gjyqtar i divizioneve civile të GjTh-ve dhe degëve të tyre ka pranuar nga afërsisht 243 lëndë civile të reja në punë.

Në anën tjetër, nisur nga fakti se gjatë vitit 2019 të gjithë gjyqtarët e divizioneve civile të GjTh-ve dhe degëve të tyre kanë zgjidhur 20.335 lëndë, i bie se gjatë këtij viti, mesatarisht secili gjyqtar ka zgjidhur nga 205.4 lëndë civile, përkatësisht nga 17.1 lëndë civile brenda muajit.

KGJK, më 11 shtator 2011 ka miratuar Rregulloren për Caktimin e Normave të Punës së Gjyqtarëve, e cila rregullore më asnjëherë nuk është rishikuar nga ana e KGJK-së. Bazuar në këtë rregullore, gjyqtarët e divizioneve civile janë të obliguar që brenda muajit të zgjidhin nga 27 lëndë, derisa brenda vitit, të njëjtit gjyqtarë duhet të zgjidhin nga 329 lëndë.

Në këtë mënyrë, nisur nga fakti se gjyqtarët e divizioneve civile të GjTh-ve dhe degëve të tyre gjatë vitit 2019 kanë kryer mesatarisht nga 205.4 lëndë, i bie se të njëjtit nuk kanë arritur të zgjidhin lëndë aq sa e ka parashikuar edhe KGJK me anë të Rregullores për Caktimin e Normave të Punës së Gjyqtarëve. Përkatësisht, gjatë vitit 2019, këta gjyqtarë mesatarisht kanë zgjidhur nga 123.6 lëndë më pak se sa kjo normë orientuese.

Kryesuesi i KGJK-së, Sknder Çoçaj, ka thënë se kjo normë është orientuese, dhe jo obligative:

“Gjyqtarët siç e dini nuk janë të obliguar rreth numrit të caktuar të lëndëve që do ti zgjidhin sepse ajo do të ndikonte direkt në efikasitetin e sistemit gjyqësor, andaj edhe përdoret termi “orientuese”, d.m.th. jo obligative, sepse nëse zgjidhja e lëndëve ndërlihet vetëm me numra atëherë ajo do të ndikonte në cilësinë e vendimeve gjyqësore. Kurse ju e dini që KGJK ka mekanizma të tjerë sa i përket vlerësimit të performancës së gjyqtarëve, përmes akteve të brendshme të saj e që zbatohen në raste të tilla” thuhet në përgjigjen e Kryesuesit Çoçaj dhënë për këtë raport²⁵.

Në fund të periudhës 2019, kemi gjithsej 47.926 lëndë civile të pazgjidhura dhe nëse secili prej 99 gjyqtarëve të divizioneve civile do të arrinte normën vjetor të përcaktuar në normën orientuese të KGJK, gjegjësisht sikur prej 99 gjyqtarëve të kryente 329 lëndë civile në vit, atëherë në fund të vitit 2019, do të kishim gjithsej 32.571 lëndë të zgjidhura të cilat do të zbritnin numrin e lëndëve të pazgjidhura në 35.690 lëndë civile.

Në këtë mënyrë, sikur kjo normë të zbatohet nga ana e gjyqtarëve, me këtë trend të lëndëve të pranuar, lëndët e pazgjidhura të cilat barten vit pas viti do të zgjidheshin për në një periudhë rreth katër (4) vite.

Aplikimi në tërësi i norma orientuese e miratuar në KGJK-së është më së e domosdoshme që të ulët numri i lëndëve të pazgjidhura, të cilën normë gjyqtarët duhet ta përcaktojnë si detyrim gjatë fushveprimtarisë dhe jo çështje diskrecionale, në atë mënyrë që moszbatimi i së njëjtës

²⁵ Po aty.

duhet të prodhojë pasoja ligjore për gjyqtarët. Në këtë drejtim, përderisa KGJK ka një rregullore e cila përcakton normat orientuese për gjyqtarë, të cilën normë gjyqtarët nuk e arrijnë, është e pakuptimtë që sistemi gjyqësor të kërkojë zgjidhjen në fusha tjera. Kjo të paktën deri në momentin kur KGJK rishqyrton Rregulloren për Caktimin e Normave të Punës së Gjyqtarëve.

Mbajtja përgjegjës e gjyqtarëve të cilët nuk e arrijnë normën vjetore të përcaktuar nga KGJK, krahas domosdoshmërisë që KGJK t'i rishqyrtojë këto norma orientuese, do ti jepte mundësi KGJK-së që aktivisht të angazhohet në rolin që ka në raport me uljen e numrit të lëndëve.

Për këtë arsye, KGJK duhet të rianalizojë në detaje dhe të jap përkushtim maksimal për ndryshimin e rregullores mbi normat orientuese, marrë për bazë faktin se numri i lëndëve civile të cilat barten vit pas viti, është problemi kryesor i sistemit gjyqësor, sa i përket drejtësisë civile.

Vetëm pas këtij rianalizimi dhe mbajtjes përgjegjës të gjyqtarëve që kanë performancë të dobët sipas ligjit dhe politikave të KGJK-së, atëherë gjyqësori mund të angazhohet që të kërkojë rritjen e numrit të gjyqtarëve në divizionet civile.

Në anën tjetër, gjatë vitit 2019, divizionet civile të GjTh-ve dhe degëve të tyre kanë qenë të ngarkuara edhe më lëndë të natyrës trashëgimore dhe jashtë kontestimore.

Gjatë këtij viti, këto divizione kanë pasur në punë gjithsej 1.606 lëndë të natyrës trashëgimore, ku kanë zgjidhur 849, derisa kanë pasur në punë edhe 8.097 lëndë të natyrës jokontestimore, prej të cilave i kanë zgjidhur 4.002.

Në këtë mënyrë, krahas lëndëve të tjera civile, gjyqtarët e divizioneve civile të GjTh-ve dhe degëve të tyre gjatë vitit 2019 kanë qenë të ngarkuar edhe me nga 16.2 lëndë trashëgimore dhe 81.7 lëndë jashtë kontestimore, ku gjatë vitit 2019 mesatarisht kanë zgjidhur nga 8.5 lëndë trashëgimore dhe nga 40.4 lëndë jashtë kontestimore.

Gjatë vitit 2019, KGJK ka lansuar “*Pasqyrën e performancës*”, e cila është një platformë që jep të dhëna të detajuara mbi performancën e secilit gjyqtar. Lidhur me këtë platformë, IKD vlerëson se lansimi i së njëjtës paraqet një hap pozitiv në drejtim të ngritjes së transparencës së sistemit gjyqësor.

Nga të dhënat që pasqyrohen në këtë platformë, ashtu si edhe në fushat e tjera, edhe në mesin e gjyqtarëve të divizioneve civile të GjTh-ve dhe degëve të tyre shihet se ka një disbalancë të theksuar në numrin e lëndëve të zgjidhura.

Në këtë drejtim, sipas të dhënave të paraqitura në këtë platformë, gjyqtarët që gjatë vitit 2019 kanë zgjidhur më së shumti lëndë janë gjyqtari i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, Binak Duqi, me gjithsej 611 lëndë të zgjidhura, pasuar nga gjyqtari i po kësaj gjykate, Nazmi Neziri, me gjithsej 469 lëndë të zgjidhura dhe gjyqtari i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Hasim Sogojeva, me 322 lëndë të zgjidhura etj.

Në anën tjetër, ka edhe gjyqtarë të tjerë të cilët për gjatë gjithë vitit kanë zgjidhur më pak se 50 lëndë civile, por se për shkak të paqartësive lidhur me angazhimin real të gjyqtarëve gjatë vitit 2019, nga “*pasqyra e performancës*” nuk është e mundur që të nxjerrën të dhëna reale mbi emrat e gjyqtarëve me efikasitetin më të ulët gjatë vitit 2019.

4.2.Mënyra e zgjidhjes së lëndëve civile gjatë vitit 2019 nga Gjykatat Themelore të Kosovës

Gjatë vitit 2019, kanë qenë në punë gjithsej 68.261 lëndë ndërsa prej tyre janë zgjidhur 20.335 lëndë civile.

Numri më i madh kontestesh civile kanë qenë konteste nga kategoria e kompensimit të dëmit (21.476), pasuar nga kontestet nga e drejta e pronësisë (15.891), konteste të dala nga marrëdhëniet kontraktuese (13.638), konteste nga e drejta familjare dhe e trashëgimisë (5.835), konteste të punës (6.580) dhe 4.841 lëndë nga konteste të tjera.

Ndërsa, sa i përket mënyrës së zgjidhjes së rasteve civile nga divizionet civile të GjTh-ve dhe degëve të tyre, mënyra më e shpeshtë e zgjidhjes së lëndëve është përmes aktgjykimit meritor me gjithsej 9.644 lëndë, me marrëveshje gjyqësore 2.227, me hudhje të padisë 651, me tërheqje të padisë 5.042 lëndë, me ndërprerje të procedurës në 1.229 lëndë, derisa 1542 lëndë janë zgjidhur në mënyra të tjera.

Lloji i kontestesh	Numri i lëndëve në punë	Aktgjykim meritor	Marrëveshje Gjyqësore	Hudhje e Padisë	Tërheqje e padisë	Ndërprerje e Procedurës	Mënyra të tjerë
Kontestet nga marrëdhëniet familjare dhe martesore	5717	207 2	91	52	549	41	159
Kontestet nga trashëgimisë	118	4	2	0	2	0	1
Kontestet nga e drejta reale(pronësore)	15891	173 2	161	138	997	489	302
Kontestet në bazë të kontratës dhe	13638	131 3	521	95	823	179	213

veprimeve juridike							
Kontestet nga lëmia e ndërtimtarisë	61	1	4	0	5	0	0
Kontestet lidhur me komunalitet dhe shërbimet e ngjashme	1696	28	6	1	42	4	5
Kontestet për kompensim dëmi	21476	2293	1271	235	1885	398	590
Kontestet e punës	6580	1728	76	79	431	55	143
Kontestet tjera të cilat nuk janë sistemuar në kontestet e mësipërme	3084	473	95	51	278	63	129
Totali	68261	9644	2227	651	5042	1229	1542

Tabela 1 - Ngarkesa me lëndë dhe mënyra e kryerjes së lëndëve civile sipas llojit të kontestit për vitin 2019.


5. Ngarkesa me lëndë civile e Gjykatës së Apelit në vitin 2019

Bazuar në raportet statistikore të publikuara nga KGJK, Gjykata e Apelit gjatë vitit 2019 ka pasur në punë gjithsej 18,344 lëndë civile, 11,551 prej të cilave i ka trashëguar nga viti paraprak, derisa gjatë vitit 2019 i ka pranuar edhe 6,793 lëndë të reja. Ndërsa, gjatë vitit 2019, kjo gjykatë ka zgjidhur gjithsej 8,428 lëndë civile.

Bazuar në këto statistika, rezulton se Gjykata e Apelit gjatë vitit 2019 ka pasur një ulje të lehtë të numrit të lëndëve të pazgjidhura të cilat barten vit pas viti.

Gjykata e Apelit në vitin 2019 ka trashëguar 11,551 lëndë civile, derisa në fund të vitit 2019 ky numër është ulur për 1,635 lëndë civile, përkatësisht në 9,916 lëndë civile të pazgjidhura.

Gjatë vitit 2019, Gjykata e Apelit ka pranuar 6,793 lëndë të reja civile, derisa ka zgjidhur 8,428 lëndë civile. Pra, gjatë vitit 2019, divizioni civil i kësaj gjykate ka zgjidhur 1.635 lëndë civile më shumë sesa janë pranuar, numër ky që reflekton shkallën e uljes së numrit të lëndëve të pazgjidhura të cilat barten vit pas viti.



Grafika 3: Lëndët e pranuar vs lëndët e zgjidhura civile në Gjykatën e Apelit gjatë vitit 2019.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë mbi trendin e efikasitetit të Gjykatës së Apelit në rastet civile, duhet shikuar edhe trendin e lëndëve të zgjidhura, të pazgjidhura dhe të pranuar në vitet 2016, 2017 dhe 2018 në Gjykatën e Apelit.


Trendi i rritjes së lëndëve të pazgjidhura ishte karakteristikë për Gjykatën e Apelit, pasi që prej vitit 2016 deri në vitin 2018, numri i lëndëve të pazgjidhura ishte rritur vit pas viti, gjersa ky numër është ulur në vitin 2019.

Në vitin 2016, në Gjykatën e Apelit kishin mbetur të pazgjidhura gjithsej 9.862 lëndë, derisa në vitin 2017 ky numër ishte rritur për 1.463 lëndë (11.325 lëndë të pazgjidhura) dhe në vitin 2018 për 226 lëndë të tjera (11.551 lëndë të pazgjidhura), ndërsa me 2019 të pazgjidhura kanë mbetur 9.916 lëndë civile.

Gjykata e Apelit në vitin 2019 ka zgjidhur më shumë lëndë civile se sa që ka pranuar, gjë që paraqet ndryshim në raport me tre vitet paraprake.

Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit në vitin 2016 kishte pranuar 5.085 lëndë civile dhe ka zgjidhur 3.554 lëndë, apo 1.531 lëndë më pak sesa ka pranuar. Në vitin 2017, kjo gjykatë kishte zgjidhur 1.463 lëndë më pak sesa ka pranuar, përkatësisht kishte zgjidhur vetëm 4.400 lëndë derisa kishte pranuar 5.863 lëndë të reja. Kurse në vitin 2018, Gjykata e Apelit kishte zgjidhur 5.461 lëndë përderisa kishte pranuar 5.687 lëndë të reja, pra 266 më pak të zgjidhura. Për këto tri (3) vite, kjo diferencë në numrin e lëndëve paraqet ngritjen e numrit të lëndëve të pazgjidhura të cilat barten vit pas viti.

Por, për dallim nga tri (3) vitet paraprake, kthesa ka ndodhur në vitin 2019, pasi Gjykata e Apelit gjatë këtij viti ka zgjidhur më shumë lëndë sesa ka pranuar. Përkatësisht, gjatë vitit 2019, Gjykata e Apelit ka zgjidhur 1,635 lëndë civile më shumë sesa ka pranuar. Në këtë rast, ky numër paraqet nivelin e uljes së numrit të lëndëve të pazgjidhura të cilat barten vit pas viti.



Grafika 4: Trendi i lëndëve civile të pazgjidhura në GJA: 2016-2019.

Arsyeja kryesore e uljes së numrit të lëndëve civile të pazgjidhura në GjA është se në fillim të vitit 2019, në këtë gjykatë janë avancuar edhe 10 gjyqtarë të rinjë, 9 prej të cilëve janë angazhuar në Divizionin Civil të kësaj gjykate dhe rrjedhimisht, rritja e numrit të gjyqtarëve në këtë departament ka ndikuar edhe në rritjen e performancës së kësaj gjykate.

Për më tepër, GjA gjatë vitit 2019 ka arritur që të zgjidhë lëndë më shumë se sa që ka pranuar, përkundër faktit se gjatë këtij viti, kjo gjykatë ka pasur numrin më të madh të lëndëve të pranuar në krahasim me tri (3) vitet e fundit.

Nëse e krahasojmë nivelin e zbritjes së numrit të lëndëve të pazgjidhura gjatë vitit 2019 në raport me numrin e lëndëve të pazgjidhura që kanë mbetur në fund të vitit 2019, atëherë gjejmë se me këtë trend të zbritjes së numrit të lëndëve të pazgjidhura civile, GjA do të arrijë të zgjidhë këto lëndë brenda (6) viteve, me ç'rast do të arrijë stabilitetin me lëndë civile. Për këtë arsye, IKD konsideron se GjA tanimë ka hyrë në binarët e stabilizimit me lëndë civile.

5.1.Performaca e zgjidhjes së rasteve civile në Gjykatën e Apelit

Bazuar në të dhënat zyrtare të KGJK-së , Gjykata e Apelit gjatë vitit 2019 ka zgjidhur gjithsej 8.428 lëndë civile, ka pranuar 6.793 lëndë të reja, ka trashëguar nga viti 2018 11.551 lëndë, derisa në total, gjatë vitit 2019, GjA ka pasur në punë gjithsej 18.344 lëndë civile.

Në Gjykatën e Apelit janë të angazhuar gjithsej 28 gjyqtar në divizionin civil.

Shprehur në mesatare, i bie se gjatë vitit 2019, secili nga gjyqtarët e këtij divizioni ka qenë i ngarkuar me nga 655.1 lëndë civile, prej të cilave mesatarisht secili gjyqtar ka zgjidhur 301 lëndë civile apo 25.08 lëndë civile për çdo muaj, ndërsa secili gjyqtar në fund të vitit 2019 ka lënë të pazgjidhura 354.1 lëndë civile.

Sipas rregullores për caktimin e normave të punës së gjyqtarëve, të miratuar nga KGJK më 14 shtator 2011, norma mujore e një gjyqtari në GjA - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni civil është 18, ndërsa norma vjetore 219 .

Shprehur në mesatare, secili nga gjyqtarët e divizionit civil e ka arritur normën orientuese të përcaktuar nga KGJK. Për më tepër, sipas përlllogaritjes në mesatare, gjyqtarët e divizionit civil të GjA-së e tejkaluar këtë normë orientuese të përcaktuar nga KGJK për 82 lëndë më shumë.

Bazuar në raportin individual të gjykatësve të Gjykatës së Apelit, rezulton se shumica e gjykatësve e kanë arritur normën orientuese, me përjashtim të tre (3) gjyqtarëve të Divizionit të GjA-së në Mitrovicë, përkatësisht gjyqtarët Blagoje Miletic, Mriko Rakiq dhe Miroslav Ivanovic. Gjyqtarët Rakiq dhe Ivanovic tanimë janë pensionuar.

Me numrin më të lartë të lëndëve civile të kryera në Gjykatën e Apelit gjatë vitit 2019 prinë Kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, me 769 lëndë civile të kryera, apo trefish më shumë sesa norma orientuese dhe dyfish më shumë sesa numrin e lëndëve që kanë zgjidhur gjykatësit tjetër të Apelit.

Për nga numri i lëndëve të zgjidhura, Kryetari Shala pasohet nga gjyqtari Rafet Haxhaj me 389 lëndë të kryera, gjykatësi Valon Totaj me 346 lëndë civile të kryera dhe gjykatësi Lumni Sallauka me 338 lëndë të kryera gjatë vitit 2019.

6. Trajtimi i rasteve civile në Gjykatën Supreme

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2019 ka pasur në punë gjithsej 566 lëndë civile (Revizion, Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, përsëritje e procedurës dhe civile të ndryshme), ku 74 lëndë janë trashëguar nga viti 2018, derisa gjatë vitit 2019 janë pranuar 492 lëndë të reja.

Nga ky total i lëndëve civile, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2019 ka zgjidhur 444 lëndë civile, ndërsa në fund kanë lënë të pazgjidhura 122 lëndë civile. Në këtë mënyrë, Gjykata Supreme ka zgjidhur 78.44 përqind të lëndëve civile në raport me lëndët që ka pasur në punë.

Bazuar në statistikat e lartcekura, vërehet se Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka zgjidhur më shumë lëndë sesa ka pranuar, gjegjësisht ka zgjidhur 47 lëndë më pak sesa ka pranuar dhe si rrjedhojë, në krahasim me vitin 2018, Gjykata Supreme në vitin 2019 e ka rritur numrin e lëndëve të pazgjidhura për 47 lëndë civile.

Duhet cekur se për shkak të natyrës së lëndëve të cilat trajtohen nga Gjykata Supreme kemi numër më të ulët të kërkesave në Gjykatën Supreme në raport me gjykatat themelore dhe Gjykatën e Apelit, ngase Gjykata Supreme pranon dhe shqyrton vetëm mjetet e jashtëzakonshme juridike si gjykatë e instancës së fundit.


Përkundër faktit se numri i lëndëve të pazgjidhura është rritur lehtësisht ky fakt mund të arsyetohet me specifika të lëndëve dhe jo me mungesë të efikasitetit të Gjykatës Supreme në këto lëndë, pasi kjo gjykatë cilësohet si gjykata e cila e ka arritur stabilitetin në kuptim të zgjidhjen së lëndëve civile lidhur me mjetet e jashtëzakonshme juridike, duke siguruar efektivitet dhe trajtim në kohë të arsyeshme të lëndës civile. Pra, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës kohë më parë ka arritur stabilitetin me lëndë.

7. Gjetjet e monitorimit të IKD-së në trajtimin e rasteve civile

IKD përpos monitorimit sistematik në trajtimin e rasteve të korrupsionit, krimeve të rënda, departamenteve të përgjithshme dhe rasteve administrative, ka monitoruar edhe rastet civile në të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe degët e tyre. Gjatë periudhës kohore prej 1 janar 2019 deri më 31 dhjetor 2019, IKD ka monitoruar gjithsej 1.715 seanca të natyrës civile në të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës.

Prej 1.715 seancave të monitoruara nga IKD, 1.337 janë mbajtur ndërsa 378 janë shtyrë për arsye të ndryshme. Përkatësisht, 139 seanca civile janë shtyrë për shkak të mungesës së paditësit, 92 seanca janë shtyrë për shkak të mungesës së gjykatësit, 88 seanca janë shtyrë për shkak të mungesës së të paditurit dhe 5 seanca janë shtyrë për arsye tjera. Shprehur në përqindje, i bie se nga totali i seancave të monitoruara, 77.95% të seancave janë mbajtur, derisa 22.04% të seancave janë shtyrë.

Në GjTh të Prishtinës janë monitoruar gjithsej 925 seanca, prej të cilave 730 janë mbajtur, kurse 195 janë shtyrë për arsye të ndryshme. Në GjTh të Prizrenit janë monitoruar 57 seanca, 35 prej tyre janë mbajtur, ndërsa 22 janë shtyrë. Në GjTh të Gjilanit IKD ka monitoruar 127 seanca, prej të cilave 100 janë mbajtur, kurse 27 janë shtyrë. Në GjTh të Pejës janë monitoruara 249 seanca, prej të cilave 186 janë mbajtur, ndërsa 63 janë shtyrë. Në GjTh të Mitrovicës, IKD gjatë vitit 2019 ka monitoruar 105 seanca, 89 prej të cilave janë mbajtur, ndërsa 16 janë shtyrë. Në GjTh të Gjakovës janë monitoruar 121 seanca, prej të cilave 97 janë mbajtur, ndërsa 24 janë shtyrë dhe në GjTh në Ferizaj IKD ka monitoruar 131 seanca prej të cilave 100 seanca janë mbajtur, ndërsa 31 seanca janë shtyrë për arsye të ndryshme.²⁶



Grafika 5: Numri i seancave civile të monitoruara nga IKD në GjTh: 1 janar - 31 dhjetor 2019.

²⁶ Platforma e Monitorimit të Gjyqësorit”. IKD. (Shih linkun <https://ejudiciary.org/kli>). (Qasur për herë të fundit më 11 nëntor 2020).

Si rezultat i monitorimit sistematik, IKD në këtë pjesë të raportit ka paraqitur edhe gjetjet në këto raste si dhe ka trajtuar raste të përzgjedhura karakteristike.

Sa i përket trajtimit të rasteve civile në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës, IKD gjen se ky sistem edhe në vitin 2019 nuk ka arritur që të ofrojë një mjet efikas juridik për këto raste.

Por, sa i përket mjetit efikas juridik, kjo nuk ndodh kështu me të gjitha rastet civile. Kjo pasi që gjatë procesit të monitorimit të këtyre rasteve, IKD ka gjetur raste të cilat paraqesin qasje selektive nga ana e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim, përderisa kemi raste të cilat as pas dy dekadave nuk kanë marrë një përgjigje përfundimtare nga sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës, ka raste të tjera të cilat kanë përfunduar brenda 35 ditëve. Në vijim të këtij raporti do të pasqyrohen edhe rastet kur për të caktuar një seancë përgatitore nevojitet vitet të tëra, ndërsa ka raste tjera kur seanca e tillë caktohet brenda afatit ligjor.

IKD gjen se personat fizik apo juridik të cilët kërkojnë të realizojnë të drejtat subjektive civile, janë viktimë e zvarritjeve në disa faza të procedurës, duke filluar në caktimin e seancës përgatitore, komunikimit përmes parashtrësive nga paditësit dhe të paditurit, më ç’rast gjykata nuk kujdeset të bëjë një administrim të drejtë të drejtësisë dhe t’i mbrojë palët nga zvarritja e procedurës, etj.

Po ashtu, në rastet civile dukuria e kthimit të lëndëve në rigjykim nga GjA vazhdon të jetë sfidë e cila krijon “ping-pongun” me lëndë në mes instancave të ndryshme brenda sistemit gjyqësor. Në këtë mënyrë, kjo qasje e GjA përpos që zvarritë qytetarët në realizimin e të drejtave të tyre përmes rrugëve gjyqësore, ngarkon edhe sistemin gjyqësor me numër të lëndëve.

Në vijim, IKD ka paraqitur në mënyrë të detajuar disa prej gjetjeve kryesore nga procesi i monitorimit të rasteve civile gjatë vitit 2019.

7.1.Dështimi i sistemit gjyqësor për të zbatuar detyrimin kushtetues për zgjidhjen e lëndëve në kohë të arsyeshme

Republika e Kosovës ka ndërmarrë detyrime në rrafshin teorik dhe formal që të ndërmarrë masa efektive për të zbatuar të drejtat dhe liritë të cilat rrjedhin nga KEMDNJ, ku një ndër të drejtat të cilat kanë qytetarët e Kosovës është që sistemi juridik për çështjet e tyre civile të siguroj një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe brenda një afati të arsyeshëm kohorë.

Mirëpo, përkundër të drejtave në letër, në rrafshin praktik, praktika gjyqësore dhe të dhënat statistikore tregojnë se e drejta për zgjidhjen e lëndëve civile në kohë të arsyeshme mbetet vetëm si çështje e sanksionuar në ligj, derisa e njëjta nuk reflektohet në praktikë.

KGJK ka bërë publikimin e statistikave vjetore në nivel vendi për rastet civile. Bazuar në këto statistika dhe në përdorimin e metodës së përdorur nga CEPEJ për të vlerësuar performancën

e gjykatës, është nxjerrë edhe mesatarja e përfundimit të një lëndë civile duke bazuar në statistikat e KGJK-së. Metoda nga CEPEJ për kohën e nevojshme për likuidimin e lëndëve siguron një vështrim lidhur me kohën e marrë nga një lëndë e caktuar për t'u zgjidhur. Ky tregues pjesëton numrin e përgjithshëm të lëndëve të pranuar të pazgjidhura në përfundim të periudhës përkatëse, me numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë së njëjtës periudhë, duke e konvertuar këtë përpjesëtim në ditë.

Bazuar në këtë formulë, sipas statistikave të publikuara nga KGJK dhe formulës së lartcekur rezulton se gjatë vitit 2019 për të përfunduar një rast civil në gjykatën e shkallës së parë duhet të kalojnë mesatarisht 860 ditë, derisa për tu zgjidhur një rast nga GjA duhet të kalojnë 429.4 ditë. Nisur nga fakti se një rast civil konsiderohet i formës së prerë pas marrjes së aktgjykimit nga Gjykata e Apelit, matja e kohëzgjatjes së një lëndë civile duhet të bëhet nga dita e paraqitjes së padisë deri në marrjen e vendimit nga Gjykata e Apelit. Në total, bazuar në këtë metodë, rezulton se kohëzgjatja e një procesi civil nga dita e paraqitjes së padisë deri në marrjen e formës së prerë pas vendimit të Gjykatës së Apelit është 1.289 ditë.

Por, duhet cekur se kjo metodologji e CEPEJ e cila përdoret edhe nga KGJK tregon vetëm një mesatare teorike, derisa nuk ofron një statistikë të saktë bazuar në rrafshin praktik të secilit rast veç e veç. Si i tillë, ky tregues nuk arrin të tregojë natyrën e përzier, përqendrimin apo meritën e lëndëve të ndryshme.

Sidoqoftë, mesatarja e përgjithshme e përfundimit të një rasti civil prej 1.289 ditëve, paraqet dështim i sistemit gjyqësor për trajtim efikas dhe në kohë të arsyeshme të rasteve civile, dhe dështim të sistemit gjyqësor për të siguruar një mjet efektiv juridik në rastet civile.

Në anën tjetër, për të vlerësuar praktikisht kohëzgjatjen e një procedure civile nga momenti i parashtrimit të padisë e deri në momentin kur rasti merr formën e prerë, IKD ka analizuar 104 aktgjykime të natyrave civile, të publikuara nga KGJK.

Bazuar në këtë analizë, IKD ka gjetur se nga momenti i ngritjes së padisë deri në marrjen e formës së prerë të një rasti civil, duhet të kalojnë mesatarisht 2.801 ditë, apo rreth 7 vite e 8 muaj, statistikë kjo që e tej argumenton faktin e mungesës së një mjeti efektiv juridik për qytetarët në rastet civile.

Në këtë drejtim, IKD ka gjetur se procedura civile si tërësi nuk do të kishte zvarritje nëse në çdo fazë të procedurës kontestimore do të kishte zbatueshmëri të detyrimeve ligjore nga ana e gjykatësve, si në dorëzimin e shkresave palëve dhe caktimin e seancave civile.

Me këtë rast. IKD gjen se një fazë e cila paraqet zvarritje të madhe të procedurave civile është faza e dorëzimit të padisë të paditurit dhe dhënia e përgjigjes në padi nga ana e të paditurit. Neni 394 i Ligjit Nr.03/L-006 të Procedurës Kontestimore përcakton se *“Gjykata padinë, me shkresat e bashkangjitura, ia dërgon të paditurit për përgjigje brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur është paraqitur në gjykatë padia e rregullt dhe e plotë”*. Kurse në nenin 395 të këtij ligji përcaktohet se *“I padituri, pasi t'i dorëzohet padia, me shkresat e*

bashkangjitura eventualisht, ka për detyrë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, të përgjigjet me shkrim në padi.”

Nga analizimi i 40 aktgjykimeve për qëllime të kësaj pjese procedurale, IKD ka gjetur se në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës ka raste kur nga paraqitja e padisë e deri në pranimin e përgjigjes në padi kanë kaluar mbi 11 vite, apo 4.059 ditë. Nga analizimi i këtyre aktgjykimeve, të publikuara në faqet zyrtare të gjykatave, IKD gjen se mesatarja e kohëzgjatjes nga ushtrimi i padisë e deri në pranimin e përgjigjes në padi është rreth tri (3) vite. Nisur nga fakti se ky veprim është një veprim fillestar në procedurën civile, mund të konkludohet se me këtë mënyrë të veprimit, procedura civile ende pa filluar fillon me zvarritje.

Numri i lëndës	Data e ushtrimit të padisë	Data e përgjigjes në padi	Kohëzgjatja
C.nr.376/16	19.02.2016	31.01.2019	2 vjet, 11 muaj, 12 ditë
C.nr.405/2017	22.11.2017	19.11.2019	1 vjet, 11 muaj , 28 ditë
C.nr.47/2018	28.12.2018	16.12.2019	11 muaj, 18 ditë
C.nr.5/14	08.01.2014	02.11.2017	3 vjet, 9 muaj, 25 ditë
C.nr.862/15	14.04.2015	12.01.2019	3 vjet, 8 muaj, 29 ditë
C.nr.2652/16	03.11.2016	18.03.2019	2 vjet, 4 muaj, 5 ditë
C.nr.2873/12	06.11.2012	27.09.2016	4 vjet, 21 ditë
C.nr.1121/16	12.12.2016	29.10.2018	1 vjet, 10 muaj, 17 ditë
C.nr.517/18	24.05.2018	25.07.2018	2 muaj, 1 ditë
C.nr.1206/18	05.11.2018	23.09.2019	1 vjet, 18 ditë
C.nr.822/19	12.07.2019	08.11.2019	3 muaj, 27 ditë
C.nr.2729/13	17.10.2013	01.12.2017	4 vjet, 1 muaj, 14 ditë
C.nr.3449/18	22.11.2018	13.03.2019	3 muaj, 19 ditë
C.nr.307/15	29.12.2015	15.10.2019	3 vjet, 9 muaj, 16 ditë
C.nr.439/16	05.10.2016	01.02.2019	2 vjet, 3 muaj, 27 ditë
C.nr.996/16	05.05.2016	31.01.2019	2 vjet, 8 muaj, 26 ditë

C.nr.3257/15	29.12.2015	09.02.2018	2 vjet, 1 muaj, 11 ditë
C.nr.2533/18	11.06.2012	14.04.2015	2 vjet, 10 muaj, 3 ditë
C.nr.800/15	03.04.2015	12.02.2019	3 vjet, 10 muaj, 9 ditë
C.nr.376/16	19.02.2016	31.01.2019	2 vjet, 11 muaj, 12 ditë
C.nr.944/16	29.04.2016	11.02.2019	2 vjet, 9 muaj, 13 ditë
C.nr.1503/16	07.07.2016	19.09.2017	1 vjet, 3 muaj, 12 ditë
C.nr.2561/16	03.11.2016	31.01.2018	1 vjet, 2 muaj, 28 ditë
C.nr.247/17	03.02.2017	15.11.2017	9 muaj, 12 ditë
C.nr.2474/19	22.07.2019	24.10.2019	3 muaj, 2 ditë
C.nr.735/07	16.03.2007	29.03.2012	5 vjet, 13 ditë
C.nr.781/16	08.04.2016	06.08.2018	3 vjet, 3 muaj, 29 ditë
C.nr.993/14	03.04.2014	13.03.2018	3 vjet, 11 muaj, 10 ditë
C.nr.492/07	22.02.2007	26.03.2018	11 vjet, 1 muaj, 4 ditë
C.nr.3192/18	30.10.2018	16.05.2019	6 muaj, 16 ditë
C.nr.3706/18	17.02.2018	11.01.2019	11 muaj, 4 ditë
C.nr.299/16	05.12.2016	18.08.2017	8 muaj, 13 ditë
C.nr.884/19	07.10.2019	25.11.2019	1 muaj, 18 ditë
C.nr.1010/18	22.11.2018	24.01.2019	2 muaj, 2 ditë
C.nr.257/16	14.03.2016	14.03.2017	1 vjet
C.nr.876/2014	08.12.2014	17.11.2016	1 vjet, 11 muaj, 9 ditë
C.nr.413/17	31.07.2017	05.01.2018	5 muaj, 5 ditë
C.nr.805/18	11.05.2012	06.02.2014	2 vjet, 2 muaj, 20 ditë
C.nr.260/17	25.11.2015	24.11.2016	1 vjet
C.nr.753/17	27.07.2017	05.04.2019	1 vjet, 9 muaj, 7 ditë

Tabela 2: Koha e kaluar nga momenti i parashtrimit të padisë deri në momentin e parashtrimit të padisë.

Sipas tabelës së lartcekur, shihen raste dhe statistika të cilat tregojnë zvarritjen e theksuar në fazën e dërgimit të padisë dhe dhënien e përgjigjes në padi, i cili veprim procedural është kusht për caktimin e seancës përgatitore.

Përballë rasteve kur për këtë veprim procedural kanë kaluar mbi 11 vite, në tabelë evidentohen edhe raste të cilat janë trajtuar me efikasitet, ku shihet se koha e kaluar prej parashtrimit të padisë e deri në përgjigje në padi është vetëm 2 muaj e 2 ditë. Ky fakt pasqyron edhe trajtimin diskriminues dhe selektiv nga ana e gjykatës pasi që në disa raste kemi zvarritje të theksuara të dërgimit të padisë dhe përgjigjes në padi, ndërsa në disa raste tjera afatet ligjore zbatohen me efikasitet.

Në anën tjetër, zvarritja e procedurës civile evidentohet edhe në rastin e caktimit të seancës përgatitore, e cila sipas LPK, duhet të caktohet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita kur i padituri është përgjigjur në padi apo ka lëshuar afatit e paraqitjes së përgjigjes në padi.

Bazuar në rastet e monitoruara, IKD gjen se në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës ka pasur raste që nga data e parashtrimit të padisë e deri në caktimin e seancës përgatitore kanë kaluar shtatë (7) vite, përkundër kërkesës ligjore që kjo të bëhet brenda afatit prej 30 ditëve. Por, sa i përket caktimit të seancës përgatitore, IKD gjatë procesit të monitorimit ka gjetur se brenda sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës një qasje jo uniforme në raport me caktimin e seancave përgatitore, për shkak se ka pasur raste që seanca përgatitore nga gjykata është caktuar brenda tre (3) muajve.

Ndërsa, pas analizimit të 50 aktgjykimeve për qëllime të këtij hulumtimi, IKD ka gjetur se në mesatare, koha e kaluar nga data e parashtrimit të padisë e deri në caktimin e seancës përgatitore është rreth pesë (5) vite.

Numri i lëndës	Data e parashtrimit të padisë	Data e seancës përgatitore	Kohëzgjatja
C.nr.1677/10	23.07.2010	04.01.2017	6 vjet, 5 muaj, 12 ditë
C.nr.1188/14	23.04.2014	15.07.2019	5 vjet, 2 muaj, 22 ditë
C.nr.3257/15	29.12.2015	07.03.2019	3 vjet, 2 muaj, 3 ditë
C.nr.281/15	04.02.2015	29.10.2019	4 vjet, 8 muaj, 25 ditë
C.nr.1546/12	08.06.2012	17.04.2019	6 vjet, 10 muaj, 9 ditë
C.nr.1589/12	11.06.2012	11.03.2019	6 vjet, 9 muaj
C.nr.20/14	20.01.2014	19.06.2019	5 vjet, 4 muaj, 29 ditë
C.nr.3/15	09.01.2015	12.12.2019	4 vjet, 11 muaj, 3 ditë

C.nr.524/13	22.02.2013	19.02.2019	6 vjet
C.nr.1761/11	07.07.2011	14.03.2017	5 vjet, 8 muaj, 7 ditë
C.nr.306/18	05.09.2018	03.09.2019	11 muaj, 29 ditë
C.nr.352/16	14.12.2016	11.10.2019	2 vjet, 9 muaj, 27 ditë
C.nr.1342715	08.06.2015	24.12.2019	4 vjet, 6 muaj, 16 ditë
C.nr.2183/15	18.09.2015	08.03.2019	3 vjet, 5 muaj, 18 ditë
C.nr.2266/15	30.09.2015	19.12.2019	4 vjet, 2 muaj, 19 ditë
C.nr.2579/12	02.10.2012	26.03.2019	6 vjet, 5 muaj, 24 ditë
C.nr.2727/13	17.10.2013	23.05.2019	5 vjet, 7 muaj, 6 ditë
C.nr.2853/13	30.10.2013	06.06.2018	4 vjet, 7 muaj, 7 ditë
C.nr.244/13	25.09.2013	12.09.2019	5 vjet, 11 muaj 18 ditë
C.nr.1413/15	18.06.2015	19.04.2019	3 vjet, 10 muaj, 1 ditë
C.nr.1686/11	27.07.2011	26.06.2019	7 vjet, 11 muaj
C.nr.738/19	13.03.2019	09.07.2019	3 muaj, 26 ditë
C.nr.2188/13	03.09.2013	20.05.2019	5 vjet, 8 muaj, 17 ditë
C.nr.1277/13	30.05.2013	24.07.2019	6 vjet, 1 muaj, 24 ditë
C.nr.1336/15	08.06.2015	07.02.2020	4 vjet, 7 muaj, 30 ditë
C.nr.1025/19	05.04.2019	19.08.2019	4 muaj, 14 ditë
C.nr.3365/15	31.12.2015	22.08.2019	3 vjet, 7 muaj, 22 ditë
C.nr.2591/16	01.11.2016	04.04.2019	2 vjet, 5 muaj, 3 ditë
C.nr.1325/17	15.12.2017	17.12.2019	2 vjet, 2 ditë
C.nr.931/17	08.09.2017	10.12.2019	2 vjet, 3 muaj, 2 ditë
C.nr.74/17	01.02.2017	17.10.2018	1 vjet, 8 muaj, 16 ditë
C.nr.450/18	28.12.2018	16.10.2019	9 muaj, 18 ditë

C.nr.1109/17	25.03.2016	14.11.2019	3 vjet, 7 muaj, 20 ditë
C.nr.577/17	09.06.2017	17.10.2018	1 vjet, 4 muaj, 8 ditë
C.nr.1241/17	17.11.2017	13.11.2019	1 vjet, 11 muaj, 27 ditë
C.nr.3499/14	24.12.2014	18.06.2019	4 vjet, 6 muaj, 6 ditë
C.nr.3163/18	26.10.2018	11.09.2019	10 muaj, 16 ditë
C.nr.3000/14	06.11.2014	12.09.2019	4 vjet, 10 muaj, 6 ditë
C.nr.1082/12	07.05.2012	24.12.2019	7 vjet, 7 muaj, 17 ditë
C.nr.4/17	04.01.2017	15.05.2019	2 vjet, 4 muaj, 19 ditë
C.nr.771/17	11.11.2011	09.01.2018	6 vjet, 1 muaj, 29 ditë
C.nr.1325/17	15.12.2017	17.12.2019	2 vjet, 2 ditë
C.nr.1009/15	13.11.2015	19.11.2018	3 vjet, 6 ditë
C.nr.315/14	07.05.2014	13.08.2019	5 vjet, 3 muaj, 6 ditë
C.nr.1236/16	29.11.2016	16.01.2018	1 vjet, 1 muaj, 18 ditë
C.nr.959/14	31.12.2014	22.12.2017	2 vjet, 11 muaj, 22 ditë
C.nr.1134/13	13.05.2013	08.11.2019	6 vjet, 5 muaj, 26 ditë
C.nr.2536/15	28.10.2015	04.11.2019	4 vjet, 15 ditë
C.nr.735/12	03.04.2012	23.10.2019	6 vjet, 7 muaj, 7 ditë
C.nr.1737/12	02.07.2012	23.10.2019	7 vjet, 3 muaj, 21 ditë

Tabela 3 - Kohëzgjatja prej momentit të paraqitjes së padisë në gjykatë deri në caktimin e seancës përgatitore nga gjykata.

Në këtë kuptim, IKD gjen se dispozitat e LPK-së kanë dizajnuar një procedurë e cila do të jetë në shërbim të efikasitetit të realizimit të të drejtave të palëve, mirëpo praktika në sistemin tonë gjyqësor tregon anën tjetër të medaljes, kur afatet ligjore shërbejnë kanë mbetur në letër, të pa zbatuara në praktikë. Nga gjetjet e trajtuara si më lartë, shihet se procesit të tejzgjatjes së përgjithshme të procedurës civile i kontribuojnë zvarritjet procedurale në disa faza të veçanta procedurale, që përbëjnë zvarritjen e përgjithshme. Lidhur me kohëzgjatjen e lëndëve civile nga parashtrimi i padisë e deri në momentin kur vendimi merr formë të prerë, gjetjet e IKD-së të gjeneruara nga procesi i monitorimit të drejtpërdrejtë të rasteve civile tregojnë se ende kemi

raste civile të cilat nuk kanë marrë epilog as pas 20 vitesh prej kur janë parashtruar, derisa ka raste të tjera të cilat kanë përfunduar në afat rekord.

Kjo qasje e gjykatës, përpos që minon të drejtën për një gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme, krijon qasje të pabarabartë dhe diskriminuese ndaj qytetarëve, e cila qasje është në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit dhe me parimin që qytetarët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit dhe brenda kohës së arsyeshme. Një sjellje e tillë ndikon në humbjen e besueshmërisë së qytetarëve ndaj sistemit gjyqësor.

Me qëllim të pasqyrit të drejtë dhe praktik të kohëzgjatjes së procedurave civile, IKD ka analizuar gjithsej 105 aktgjykime të publikuara në faqet zyrtare të gjykatave. Bazuar në këtë analizë, IKD gjen se mesatarja e trajtimit të një rasti nga momenti i parashtrimit të padisë e deri në nxjerrjen e vendit të gjykatës së shkallës së parë është 1.513 ditë, derisa nga momenti i vendosjes në shkallë të parë e deri në momentin e vendosjes nga ana e GjA-së, kjo mesatare është 1.288 ditë. Shprehur në total, i bie se për të përfunduar një rast nga momenti i parashtrimit të padisë e deri në momentin kur vendimi gjyqësor merr formën e prerë, mesatarisht duhet të kalojnë 2.801 ditë, apo rreth 7 vite e 8 muaj.

Për më tepër, në Gjykatën e Apelit, janë evidentuar edhe raste kur nga momenti i vendosjes së lëndës në shkallë të parë e deri në momentin e vendosjes nga ana e Gjykatës së Apelit kanë kaluar 2.485 ditë. Në tabelën në vijim, shihet edhe trajtimi diskriminues i palëve, pasi evidentohen raste kur paraqitet disbalancë i theksuar në kohëzgjatjen e trajtimit të një rasti përballë një rasti tjetër civil.

Numri i lëndës	Data paraqitjes padisë	Data e marrjes së aktgjykimit në Gjykatën Themelore	Data e marrjes së aktgjykimit në Gjykatën e Apelit
Ac.nr.4074/15	02.11.2007	02.07.2015	29.11.2019
Ac.nr.4038/2016	30.06.2014	08.09.2016	06.12.2019
Ac.nr.1489/16	12.06.2001	09.12.2015	27.12.2019
Ac.nr.1730/16	19.03.2013	15.03.2016	30.12.2019
Ac.nr.2602/16	18.01.2007	20.01.2016	27.12.2019
Ac.nr.2392/16	29.03.2011	19.04.2016	23.12.2019
Ac.nr.1730/16	19.03.2013	15.03.2016	30.12.2019
Ac.nr.3402/16	29.08.2012	18.07.2016	30.12.2019
Ac.nr.2128/18	08.09.2015	12.03.2018	16.12.2019
Ac.nr.3087/16	30.06.2014	27.01.2016	23.01.2020
Ac.nr.626/2017	09.06.2009	09.12.2016	20.01.2020
Ac.nr.609/2016	27.11.2001	10.07.2015	23.01.2020
Ac.nr.3651/17	09.09.2016	08.06.2017	18.11.2019
Ac.nr.5136/18	30.12.2016	26.09.2018	09.12.2019
Ac.nr.3872/17	20.04.2016	02.06.2017	18.11.2019
Ac.nr.3751/17	04.07.2016	09.11.2016	04.11.2019
Ac.nr.4194/16	28.01.2014	23.09.2016	18.11.2019
Ac.nr.5279/18	01.12.2017	16.10.2018	16.12.2019
Ac.nr.795/18	17.07.2012	25.09.2017	16.12.2019,
Ac.nr.2128/18	08.09.2015	12.03.2018	16.12.2019
Ac.nr.996/18	01.03.2016	08.11.2017	16.12.2019
Ac.nr.5150/17	09.10.2013	31.10.2017	04.11.2019

Ac.nr.4074/15	02.11.2007	02.07.2015	29.11.2019
Ac.nr.4225/16	25.09.2012	11.07.2016	09.12.2019
Ac.nr.4298/16	21.09.2012	25.05.2015	18.12.2019
Ac.nr.4421/16	21.01.2014	14.03.2016	29.11.2019
Ac.nr.4430/2014	02.10.2003	07.05.2014	23.12.2019
Ac.nr.445/16	04.08.2014	18.09.2015	29.11.2019
Ac.nr.4498/16	11.06.2009	30.08.2016	18.12.2019
Ac.nr.1763/16	27.07.2012	29.02.2016	01.12.2019
Ac.nr.2073/15	26.12.2006	21.07.2014	20.12.2019
Ac.nr.2123/16	03.02.2014	19.04.2016	29.11.2019
Ac.nr.2143/2016	09.09.2011	15.04.2016	12.12.2019
Ac.nr.22/16	07.09.2009	30.01.2015	01.12.2019
Ac.nr.2247/18	24.09.2007	21.03.2018	13.12.2019
Ac.nr.2311/16	15.11.2010	18.02.2016	16.12.2019
Ac.nr.2316/16	25.02.2008	29.04.2016	18.12.2019
Ac.nr.3257/17	26.02.2014	17.01.2017	20.12.2019
Ac.nr.3348/16	29.06.2011	02.06.2016	12.12.2019
Ac.nr.3372/16	24.12.2015	15.04.2016	09.12.2019
Ac.nr.3435/14	12.02.2003	20.05.2014	16.12.2019
Ac.nr.3453/16	27.05.2009	21.04.2016	10.12.2019
Ac.nr.3563/16	29.11.2006	28.07.2016	29.11.2019
Ac.nr.3648/16	05.10.2010	14.12.2015	10.12.2019
Ac.nr.4602/16	18.09.2015	28.09.2016	09.12.2019
Ac.nr.4603/16	11.09.2009	08.07.2016	03.12.2019

Ac.nr.468/16	07.07.2014	06.10.2015	11.12.2019
Ac.nr.4861/16	19.04.2013	17.11.2016	18.12.2019
Ac.nr.4882/16	18.02.2014	03.08.2016	18.12.2019
Ac.nr.579/16	10.03.2011	10.12.2015	23.12.2019
Ac.nr.586/17	25.06.2010	12.04.2016	16.12.2019
Ac.nr.1064/16	21.10.2013	06.11.2015	29.11.2019
Ac.nr.1165/16	20.08.2014	01.12.2015	29.11.2019
Ac.nr.1167/16	04.09.2014	17.06.2015	03.12.2019
Ac.nr.1295/14	12.12.2003	11.03.2013	30.12.2019
Ac.nr.1408/16	22.04.2013	16.02.2016	09.12.2019
Ac.nr.167/16	21.08.2013	27.10.2015	03.12.2019,
Ac.nr.2600/16	14.11.2008	16.12.2015	11.12.2019
Ac.nr.2666/16	05.11.2014	31.03.2016	29.11.2019
Ac.nr.273/16	02.04.2013	03.11.2015	04.12.2019
Ac.nr.305/16	18.12.2008	29.10.2015	09.12.2019
Ac.nr.2795/15	22.09.2011	22.03.2016	18.12.2019
Ac.nr.2755/16	11.07.2014	29.04.2016,	04.12.2019
Ac.nr.3148/16	04.08.2011	17.05.2016	16.12.2019
Ac.nr.853/16	28.07.2008	08.06.2015	10.12.2019
Ac.nr.926/15	26.04.2011	26.01.2015	20.12.2019
Ac.nr.982/16	14.12.2011	16.11.2015	10.12.2019
Ac.nr.1424/16	20.01.2014	26.11.2015	29.11.2019
Ac.nr.1590/15	27.11.2008	09.10.2014	29.11.2019

Ac.nr.1599/15	05.02.2009	09.12.2014	06.11.2019
A.C.nr.1643/16	16.03.2014	17.12.2015	28.10.2019
A.C.nr.773/19	12.06.2018	21.11.2018,	30.09.2019
A.C.nr.93/2016	18.02.2015	19.10.2015	29.08.2019
Ac.nr.1724/15	09.05.2006	19.06.2014	06.11.2019
Ac.nr.1759/15	13.06.2013	22.01.2015,	06.11.2019
A.C.nr.2335/17	24.09.2014	31.03.2017	11.09.2019,
Ac.nr.2340/15	11.11.2009	14.04.2015	29.11.2019
A.C.nr.2347/19	20.09.2017	25.03.2019	09.10.2019
Ac.nr.3974/16	10.02.2004	09.09.2016	22.11.2019
Ac.nr.2659/15	16.10.2014	04.03.2015	06.11.2019
Ac.nr.2752/16	29.07.2011	03.05.2016	22.11.2019
Ac.nr.2797/16	13.03.2013	06.06.2016	22.11.2019
Ac.nr.2876/15	08.09.2003	15.06.2015	29.11.2019
Ac.nr.3087/15	22.12.2010	18.02.2015	29.11.2019
Ac.nr.3154/15	14.07.2008	21.01.2015	06.11.2019
Ac.nr.3312/16	11.02.2011	03.02.2016,	22.11.2019
Ac.nr.3371/15	01.12.2006	22.07.2015	06.11.2019
Ac.nr.3581/14	21.08.2006,	19.05.2014	30.10.2019
A.C.nr.3849/19	06.08.2018	17.05.2019	09.10.2019
AC.nr.3297/17	13.03.2013	15.06.2017	12.11.2019
AC.nr.3447/2016	27.05.2009	10.03.2016	18.11.2019
Ac.nr.3487/2017	07.04.2013	19.06.2017	18.11.2019,
AC.nr.3701/16	08.09.2008	13.10.2015	12.11.2019

AC.nr.616/17	08.11.2006	14.09.2016	15.11.2019
AC.nr.1195/15	09.11.2010	10.09.2014	15.11.2019
AC.nr.1218/15	01.04.2010	11.11.2014	18.11.2019
AC.nr.2668/16	14.05.2013	12.05.2016	18.11.2019
AC.nr.2749/15	2.06.2013	28.05.2015	15.11.2019
AC.nr.2394/16	23.07.2009	22.04.2016	15.11.2019
AC.nr.4419/16	30.12.2013	26.04.2016	12.11.2019
CA.nr.4143/2016	07.08.2012	15.04.2016	21.10.2019
CA.nr.4144/2016	17.08.2011	03.06.2016,	25.10.2019
Ac.nr.4422/16	27.01.2012	28.09.2016	14.11.2019
Ac.nr.519/16	29.08.2014	21.12.2015	14.11.2019
Ac.nr.990/16	13.11.2009	27.01.2016	01.11.2019

Tabela 4 - Pasqyrimi i trajtimit të rasteve civile nga dita e ngritjes së padisë deri në përfundimin e rastit civil në Gjykatën e Apelit.

Nga të dhënat e paraqitura si më lartë, shihet qartazi se sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës gjatë vitit 2019 nuk ka arritur që të sigurojë një mjet juridik efektiv për qytetarët, në atë mënyrë që për secilin qytetarë, gjykata të jetë adresa më efektive dhe më efikase për zgjidhjen e kontesteve civile, i cili efikasitet konsiston në respektimin e afateve të përcaktuara me ligj.

Siç edhe u argumentua, totalit të përgjithshëm të zvarritjes së rasteve gjyqësore i kontribuon prolongimi procedural në shumë faza të procedurës të cilat zhvillohen nga momenti i paraqitjes së padisë e deri në momentin kur vendimi në një rast civil merr formën e prerë.

Lidhur me kohëzgjatjen e procedurave civile, Kryesuesi i KGJK-së, Skender Çoçaj, ka thënë se *“zhvillimi dhe përfundimi i tyre varet nga shumë rrethana objektive dhe subjektive, por që nuk ndërliken direkt me menaxhimin e seancave nga gjyqtarët, të cilët përkundër këtyre shkaqeve që nuk varen prej tyre, i shfrytëzojnë mekanizmat ligjor që parashihen në legjislacionin në fuqi, për zhvillimin efikas të seancave dhe zgjidhjen e rasteve civile brenda afateve kohore, ashtu që të sigurojnë efikasitetin e procedurës. Normalisht që KGJK do të ndërmerr të gjitha veprimet adekuate që bien në kompetencën e saj kushtetuese dhe ligjore, mirëpo assesi duke ndikuar në punën e gjyqtarëve, të cilët në bazë të legjislacionit në fuqi janë të pavarur në punën e tyre. Lidhur me caktimin dhe përfundimin e rasteve civile e që ndikojnë në trajtimin e palëve në procedurë, si dhe kohëzgjatjen e tyre, ashtu siç është cekur më lartë,*

produktiviteti i seancave nuk varet vetëm nga gjyqtarët por nga rrethana ligjore dhe praktike, ndërsa caktimi dhe mbarëvajtja e tyre bëhet sipas radhës së ardhjes në gjykatë, ndërsa trajtimi i lëndëve në bazë të prioriteteve është çështje që e përcakton legjislacioni në fuqi e jo gjykata dhe gjyqtarët përkatës. Andaj konform këtyre obligimeve dhe kufizimeve, veprojnë edhe Gjykatat e Republikës së Kosovës”²⁷.

Ndërsa, Kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, ka thënë se kjo Gjykatë është duke bërë përpjekje që të zvogëlojë numrin e lëndëve të vjetra, në mënyrë që të fillojë të trajtojë lëndët e reja, derisa kur rastet të fillojnë të trajtohen brenda një afati të arsyeshëm kohor²⁸.

7.2. “Ping-pongu” gjyqësor në rastet civile

Ngarkesa më lëndë civile në gjykatat themelore nuk vjen vetëm si pasojë e paraqitjes së padive të reja nga ana e personave fizik dhe juridik. Një ngarkesë e tillë vjen edhe si pasojë e aktvendimeve të Gjykatës së Apelit të cilat i kthejnë lëndët civile në rivendosje në Gjykatat Themelore.


Bazuar në statistikat e publikuara nga KGJK-ja, rezulton se Gjykata e Apelit vit pas viti ka rritur numrin e lëndëve civile të cilat i ka kthyer në rivendosje në Gjykatat Themelore. Sa i përket kthimit të lëndëve në rivendosje, IKD ka analizuar numrit e rasteve që janë kthyer në rivendosje nga GjA gjatë vitit 2016, 2017 dhe 2018, ku gjen se kjo dukuri është rritur vit pas viti.

Përderisa në vitin 2016, GjA kishte kthyer 1,042 lëndë civile në rivendosje, ky numër ishte rritur për 192 lëndë në vitin 2017 (1,234 lëndë civile të kthyera në rivendosje nga GjA) dhe për 217 lëndë të tjera në vitin 2018 (1,451 lëndë civile të kthyera në rivendosje nga GjA).

Ndërsa, në vitin 2019 GjA ka kthyer në rivendosje 917 lëndë më shumë sesa në vitin 2018, gjegjësisht. Përkatësisht, gjatë vitit 2019, GjA ka kthyer në rivendosje gjithsej 2.368 lëndë civile në Gjykatat Themelore.

²⁷ Përgjigje e Kryesuesit të KGJK-së, Skender Çoçaj për IKD-në. 22 tetor 2020.

²⁸ IKD. Intervistë me Kryetarin e Gjykatës së Apelit, Hasan Shala. 26 tetor 2020.



Grafika 6: Numri i lëndëve civile të kthyer në rivendosje nga Gjykata e Apelit për vitet 2016, 2017, 2018 dhe 2019.

Por, kjo rritje reflektohet edhe nga një fakt tjetër, e që ka të bëjë me ngritjen e numrit të lëndëve të zgjidhura gjatë vitit përkatës. Me këtë rast, shprehur në përqindje në mes të numrit të lëndëve të kthyer në rivendosje në raport me numrin e lëndëve të zgjidhura, IKD gjen se gjatë vitit 2016, GjA kishte kthyer në rivendosje 29.31% të lëndëve të zgjidhura, në vitin 2017 kishte kthyer në rivendosje 28.04% të lëndëve të zgjidhura, në vitin 2018 kishte kthyer në rivendosje 26.57% të lëndëve të zgjidhura derisa në vitin 2019 kishte kthyer në rivendosje 28.09% të lëndëve të zgjidhura.

Pra, përderisa përqindja e numrit të lëndëve të kthyer në rivendosje në raport me lëndët e zgjidhura ka zbritur nga viti 2016 e deri në vitin 2018, IKD gjen se kjo përqindje është ngritur përsëri në vitin 2019.

Me këtë rast, IKD vlerëson se për t'i evituar vonesat e panevojshme dhe ngarkimin e GjTh-ve me lëndë që shkaktohen si pasojë e “ping pongut” të çështjeve civile prej një gjykatë në gjykatën tjetër, GjA gjatë shqyrtimit të vendimeve të atakuara të marrë përsipër zgjidhjen përfundimtare të rastit vetëm në ato raste kur vlerëson se mund të nxjerrë një vendim meritore lidhur me rastin përkitazi me vërtetimin e gjendjes faktike.

Sipas vlerësimit të IKD-së edhe GjA, sikurse gjykata e shkallës së parë është gjykatë e rregullt dhe e njëjta sipas ligjit ka autoritet që të vendosë në mënyrë të pavarur nga gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit direkt të çështjes, në bazë të provave të reja apo në bazë të marrjes rishtas të provave e konstaton drejtë gjendjen faktike dhe në bazë të kësaj ka të drejtë të vendos edhe pa e kthyer rastin në rivendosje. Për këtë arsye, GjA duhet të ndalojë praktikën e kthimit të lëndëve në rivendosje, përveç rasteve kur ky veprim është i domosdoshëm.

Kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, në një intervistë lidhur me këtë raport, ka thënë se Gjykata e Apelit është duke punuar për të ulur numrin e lëndëve që kthehen në rigjykim, por

se sipas tij, aspekti kryesor që ka ndikuar në ngritjen e numrit të lëndëve të kthyera në rigjykim është ngritja e numrit të lëndëve të zgjidhura nga Gjykata e Apelit²⁹.

²⁹ Po aty.

8. Annex 1: Analizë e rasteve civile të monitoruara ndër vite nga IKD

Pasiguria juridike: Interpretimi i ndryshëm i normës për të njëjtin rast nga divizionet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore në Pejë në rastin e Hysni Selmanajt.

Gjykata Themelore në Pejë

Nr i lëndës: E.nr.794/15

Kreditor: Hysni Selmanaj

Debitor: Komuna e Pejës

Data e paraqitjes së padisë: 29.12.2015

Sistemi gjyqësor në Republikën e Kosovës përmes vendimeve të saj jouniforme, ka kontribuar në krijimin e pasigurisë juridike të qytetarëve duke dhënë vendime të ndryshime për faktet e njëjta.

Një rast i tillë, ka ndodhur në divizionin civil dhe penal të Gjykatës Themelore në Pejë dhe Gjykatës së Apelit.

Qytetari Hysni Selmanaj, ish Drejtor i Auditimit në Komunën e Pejës, ishte pezulluar nga kjo pozitë nga ana e Komunës së Pejës me arsyetimin se, me 27 prill 2015, kryetari i Komunës së Pejës i është drejtuar Njësisë për Krime Ekonomike të Policisë së Kosovës me kërkesën për fillimin e hetimeve ndaj tij, lidhur me dyshimin se në mënyrë të kundërligjshme ka bërë tjetërsimin e pronës.

Lidhur me këtë largim nga puna, Selmanaj kishte filluar betejë ligjore me kryetarin e Pejës, Gazmend Muhaxheri, për kthimin në punë në pozitën e drejtorit të Auditimit të Brendshëm në Komunën e Pejës, të cilën betejë edhe pse e kishte fituar, një kthim i tillë nuk ishte bërë asnjëherë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës (KPMSHCK) përmes vendimit të saj më 4 dhjetor 2015 i cili është i formës së prerë, kishte detyruar Komunën e Pejës që ankuesin Hysni Selmanaj, ta kthente në vendin e mëparshëm të punës brenda dhe t'ia kompensonte pagat në afatit prej 15 ditësh, ndërsa kishte shfuqizuar vendimin e kryetarit Muhaxheri për pezullim nga puna.

Mirëpo një vendim i tillë, nuk ishte ekzekutuar asnjëherë nga ana e Komunës së Pejës, sipas konstatimeve të divizionit civil të Gjykatës Themelore në Pejë.

Duke qenë se vendimi i KPMSHCK-së është i formës së prerë, Hysni Selmanaj, paraqet propozim për përmbarrim në Gjykatën Themelore në Pejë për ekzekutimin e vendimit të KPMSHCK-së për kthimin e tij në vendin e punës, me ç'rast Gjykata e Pejës në procedurën përmbarrimore ka aprovuar kërkesën e kreditorit Hysni Selmanaj, ndërsa ka refuzuar ankesën e debitorit Komunës së Pejës ndaj aktvendimit të Gjykatës së Pejës për kthimin e kreditorit në vendin e punës.

Pavarësisht faktit se për ish-drejtorin Selmanaj, me vendimin e formës së prerë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e Apelit, është vendosur që i njëjti të kthehet në vendin e punës, Komuna e Pejës që nga viti 2016 nuk e ka kthyer atë në pozitën e drejtorit të Auditimit të Brendshëm.

Si rrjedhojë e kësaj, Gjykata Themelore në Pejë në procedurën përmbartimore vazhdimisht e ka gjobitur Komunën e Pejës për shkak të mos zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë për kthimin e tij në vendin e punës.

Me pretendimin se kryetari Muhaxheri nuk ishte duke zbatuar vendimin për kthim në punë, Prokuroria Themelore në Pejë kishte ngritur aktakuzë ndaj Muhaxherit në drejtim të veprës penale “Mosekzekutim i vendimit gjyqësor”.

Pra, lidhur me këtë çështje janë zhvilluar dy procedura gjyqësore, një në Divizionin Civil dhe një në Divizionin Penal të Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Pejë.

Divizioni Civil i Gjykatës Themelore në Pejë, në procedurën përmbartimore përmes vendimeve të saj ka konstatuar se Komuna e Pejës gjegjësisht kryetari Muhaxheri nuk ishte duke zbatuar vendimin e KPMSHCK-së për kthimin në punë të kreditorit Hysni Selmanaj, të cilat vendime i kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit

Kurse Divizioni Penal i Gjykatës Themelore në Pejë, në procedurën penale kishte hedhur poshtë aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë, duke konstatuar se kryetari Muhaxheri e kishte zbatuar vendimin e KPMSHCK-së, të cilin vendim e kishte vërtetuar Gjykata e Apelit.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

- **Procedura përmbartimore**

Komuna e Pejës vazhdimisht ka injoruar vendimet e Gjykatës Themelore në Pejë, në rastin ish-drejtorit të Auditimit të Brendshëm në Komunën e Pejës, Hysni Selmanaj, për moskthimin e tij në vendin e punës.

Pavarësisht faktit se për ish-drejtorin Selmanaj, me vendimin e formës së prerë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e Apelit, është vendosur që i njëjti të kthehet në vendin e punës, Komuna e Pejës që nga viti 2016 nuk e ka kthyer atë në pozitën e drejtorit të Auditimit të Brendshëm.

Për këtë arsye, ky vendim ishte paraqitur në procedurë përmbartimore, e cila procedurë sipas Ligjit mbi Procedurën Përmbartimore, zhvillohet pranë gjykatës.

Në këtë procedurë, Gjykata Themelore e Pejës me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, kishte shqiptuar vazhdimisht gjoba ndaj Komunës së Pejës, e në një rast edhe ndaj vet Kryetarit të Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri.

Shqiptimi i vazhdueshëm i gjobave në rastin kur një punëdhënës nuk e kthen në vendin e punës një punëmarrës është i rregulluar edhe me Ligjin e Procedurës Përmbare (LPP).

Në nenin 314 të këtij ligji thuhet se: “Përmbaremi në bazë të dokumentit përmbareues sipas të cilit punëdhënësi është i detyruar që punëtorin ta kthejë në punë, apo që ta sistemoj në vendin përkatës të punës, zbatohet me anë të caktimit të gjobave në të holla kundër punëdhënësit dhe personit përgjegjës në të”.

Bazuar në shkresat që posedon “Betimi për Drejtësi”, Gjykata Themelore në Pejë, më 15 maj 2019, pas seancës dëgjimore përmbare, ka shqiptuar 10 mijë euro gjobë ndaj Komunës së Pejës, e cila në cilësinë e debitorit nuk e ka zbatuar vendimin e Këshillit Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për kthimin e Hysni Selmanajt në pozitën e drejtorit të Auditimit të Brendshëm në komunën në fjalë.

Për të njëjtën arsye, edhe më 16 shkurt 2017, Komuna e Pejës ishte gjobitur nga Gjykata e Pejës në shumë prej 5 mijë euro

Kurse më 10 gusht 2016, Gjykata Themelore në Pejë e kishte gjobitur këtë Komunë me 1 mijë euro gjobë për mos zbatim të vendimit si dhe kryetarin e kësaj komune, Gazmend Muhaxheri, në shumë prej 500 euro.

- **Procedura penale**

Gjykata Themelore në Pejë, në gusht të vitit 2019, e kishte hudhur poshtë aktakuzën ndaj Muhaxherit, që sipas gjykatësit të rastit, Sejdi Blakaj, një gjë e tillë ka ndodhur për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari Muhaxheri e ka kryer një vepër të tillë penale.

Sipas aktakuzës së ngritur më 3 maj 2017, Gazmend Muhaxheri akuzohej se më 24 mars 2016, si person përgjegjës, në cilësinë e kryetarit të Komunës së Pejës, ka refuzuar të ekzekutojë vendimin e plotfuqishëm të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Sipas aktakuzës, pasi që Gjykata e Apelit e ka refuzuar si të pabazuar, ankesën e të autorizuarit, debitorit Komuna e Pejës, ndërsa vendimin e Gjykatës Themelore të Pejës e ka vërtetuar, i pandehuri nuk e ka ekzekutuar vendimin në fjalë.

Sipas këtij vendimi, i dëmtuari Hysni Selmanaj, është dashur të kthehet në vendin e punës si drejtor i Auditorit të Brendshëm, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, e duke i paguar 50% të pagës, nga dita e pezullimit e deri në zbatim të këtij vendimi.

Ndaj aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë për hudhjen poshtë të aktakuzës, Prokuroria Themelore në Pejë dhe pala e dëmtuar kishin paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit.

Në janar të këtij viti, Gjykata e Apelit e ka vërtetuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë, e cila e kishte hudhur poshtë aktakuzën ndaj kryetarit të Pejës, Gazmend Muhaxheri, i akuzuar për mos ekzekutim të vendimeve gjyqësore.

Një gjë të tillë, e kishte konfirmuar për “Betimi për Drejtësi”, zyrtari për informim i Apelit, Arbër Jashari.

“Është refuzuar si e pabazuara ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.493/2017, datë 16.08.2019, është vërtetuar. Ankesa e palës së dëmtuar Hysni Selmanaj, është hudhur si e palejuar”, thuhej në përgjigjen e tij.

- **Gjyqësori jep dy vendime të ndryshme në një çështje të njëjtë**

Epilogu gjyqësor nëse kryetari Muhaxheri kishte zbatuar vendimin e KPMSHC-së, që ta kthejë në punë Hysni Selmanajn, ka prodhuar dy interpretime të ndryshme ligjore, njëra në favor të Muhaxherit, e tjetra në favor të Selmanaj.

Këto dallime të interpretimeve ishin bërë fillimisht nga divizionet e Gjykatës Themelore në Pejë, vendimet e të cilave më pas i kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.

Divizioni penal e kanë interpretuar ligjin në favor të Kryetarit të Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, derisa Divizionet Civile, për të njëjtën çështje, kanë interpretuar ligjin në favor të paditësit Hysni Selmanaj.

Divizioni Civil i Gjykatës së Apelit kishte vërtetuar vendimet e Gjykatës Themelore në Pejë për shqiptimin e gjobave në lartësi prej mbi 16 mijë euro ndaj Komunës së Pejës, për shkak se kryetari Muhaxheri nuk e kishte kthyer në punë ish-drejtorin Hysni Selmanaj, përkundër vendimeve të favorshme gjyqësore për kthimin në punë.

Mirëpo, Divizionet Penale kanë dhënë një vlerësim ndryshe,.

Sipas vendimit të Divizionit Penal të Gjykatës së Apelit, kryetari Muhaxheri nuk kishte konsumuar veprën penale të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor, për shkak se sipas Apelit, i njëjti e kishte ftuar punëtorin Selmanaj të paraqitet në punë, duke lëshuar dy vendime nga ana e tij.

Divizioni Penal i Apelit, vendimin numër nr.016-1714 të datës 8 janar 2016, të lëshuar nga Kryetari i Komunës së Pejës, e cilëson zbatim të vendimit gjyqësor për kthimin në punë të dëmtuarit Hysni Selmanaj, i cili vendim ishte prova në të cilën Apeli është thirrur për hudhjen e aktakuzës ndaj Muhaxherit.

Mirëpo, ndryshe nga Divizioni Penal, Divizioni Civil i Gjykatës së Apelit, vendimin numër nr.016-1714 të datës 8 janar 2016, e cilëson si moszbatim të vendimit gjyqësor për kthimin e Selmanajt në vendin e tij të punës.

IKDka analizuar vendimet e dy divizioneve të Gjykatës së Apelit lidhur me faktin nëse kryetari i Pejës, Gazmend Muhaxheri kishte zbatuar vendimin gjyqësor për kthimin e Hysni Selmanaj në vendin e punës, për të cilat vendime Gjykata e Apelit jep interpretime të ndryshme.

Në aktvendimin e 21 nëntorit 2019 të Gjykatës së Apelit, Departamentit të Përgjithshëm, me të cilin është vërtetuar hudoja e aktakuzës ndaj Gazmend Muhaxherit për moszekutim të vendimeve gjyqësore, e të cilën e posedon “Betimi për Drejtësi”, theksohet se i akuzuari Muhaxheri ka zbatuar vendimin e Këshillimit të Pavarur Mbikëqyrës. që ta kthejë në punë të dëmtuarin Hysni Selmanaj dhe atë përmes vendimit të datës 8 janar dhe 11 janar 2016.

“Në të vërtetë nga përshkrimi i veprimeve dhe nga provat në bazë të cilave është ngritur aktakuza, del se i pandehuri në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Pejës, nga provat që i referohet prokuroria me konkretisht-specifikisht, vendimi numër 01-016-1714 dhe 01-16-2223 të datave 08.01.2016 dhe 11.01.2016, nga ana e Komunës rezultojnë me veprime në zbatimin e vendimit A/02/428/2015 të datës 4.12.2015”, thuhet në arsyetimin e Apelit.

Ndër të tjera, Divizioni Penal i Apelit arsyeton se vendimet e kryetarit të Pejës, të lëshuara me 8 dhe 11 janar 2016, konsiderohen zbatim i vendimit për kthimin e Hysni Selmanajt në pozitën e drejtorit të Auditimit.

“I pandehuri Gazmend Muhaxheri në cilësinë e kryetarit të Komunës së Pejës (debitor), ka marrë vendimin e KPM me datën 4 dhjetor 2015, ndërsa kthimin në vendin e punës të dëmtuarin Hysni Selmanaj (kreditor), ka vepruar në plotni duke respektuar vendimin e KPM, ku me datat 8 Janar dhe 11 Janar 2016, i dëmtuari është kthyer në pozitën e njëjtë(Drejtor i Auditimit të Brendshëm pranë Komunës së Pejës), e nga veprimi i tillë, del se i pandehuri nuk ka konsumuar veprën penale”, thuhet në arsyetimin e Gjykatës së Apelit të Departamentit të Përgjithshëm”, theksohet ndër të tjera në vendim të Apelit.

Në anën tjetër, Divizioni Civil i Gjykatës së Apelit ka theksuar se nxjerrja e vendimit nr. 016-1714, të datës 8 janar 2016 nga ana e Komunës së Pejës, nuk paraqiste ekzekutim të vendimit për kthimin e Selmanajt në vendin e tij të punës si drejtor i Auditimit.

“Pretendimi i të autorizuarit të debitorit se debitori ka respektuar vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës duke nxjerrë vendimin nr. 016-1714 të datës 8 janar 2016, duke e sistemuar kreditorin në vendin e punës Inspektor në Drejtorinë për Inspeksione për shkak se kreditorit i ka skaduar validiteti dhe kohëzgjatja e licencës për pozitën e Drejtorit të Auditimit, është i pabazë, për faktin se punëdhënësi e ka obligim që në tërësi ta zbatojë vendimin e Këshillimit të Pavarur Mbikëqyrës me të cilin kreditori duhet të kthehet në vendin e punës Drejtor i Auditimit të brendshëm me të gjitha të drejtat dhe detyrimet duke ia paguar 50% të pagës nga dita e pezullimit deri në zbatimin e këtij vendimi. Vetëm pas zbatimit të këtij vendimi në tërësi siç është obliguar debitori mund të konsiderohet se kemi të bëjmë me ekzekutim të vendimit. Nxjerrja e vendimit nr. 016-1714 të datës 8 janar 2016, nuk paraqet ekzekutim të vendimit”, thuhet në arsyetimin e Apelit të Divizionit Civil, të datës 24 mars 2016.

Tutje, arsyetim në një tjetër vendim të Gjykatës së Apelit të Divizionit Civil të datës 19 korrik 2019, ishte fakti se kryetari i Pejës e kishte ftuar të dëmtuarin të lajmërohet në punë, mirëpo jo në pozitën e drejtorit të Auditorit të Brendshëm.

“Ndonëse Kryetari i Komunës së Pejës, e ka ftuar kreditorin që të lajmërohet në punë, por jo në pozitën e Drejtorit të Auditimit të Brendshëm, por në pozitën e Inspektorit Komunal, e që ky vendim i debitorës, nuk është në përputhsh/mëri me vendimin e Këshillimit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A/02/428/1/2015, të datës 29.12.2015”, thuhet në arsyetimin e Apelit.

- **Rëndësia e zbatimit uniform të ligjit**

Në rastin konkret, shihet se brenda gjyqësorit të Republikës së Kosovës, Komuna e Pejës dhe Gazmend Muhaxheri në procedurë përmbartimore kanë qenë përgjegjës për mos zbatimit të vendimit gjyqësor, me ç’rast edhe janë gjobitur, derisa kjo përgjegjësi është mohuar plotësisht në procedurën penale të zhvilluar po për të njëjtin rast.

Sipas Këshillit Konsultativ të Gjykatësve Evropiane, zbatimi i barabartë dhe uniform i ligjit siguron gjeneralitetin e ligjit, barazinë para ligjit dhe sigurinë juridike.

Nga ana tjetër, nevoja për të siguruar një zbatim uniform të ligjit nuk duhet të sjellë ngurtësimin e ligjit dhe padrejtësisht të kufizojë zhvillimin e ligjit, si dhe as nuk duhet të vërë në dyshim parimin e pavarësisë gjyqësore.

Në opinionin nr.20 (2017) të këtij Këshilli thuhet se zbatimi uniform i ligjit është thelbësor për parimin e barazisë para ligjit, duke shtuar se konsideratat e sigurisë juridike dhe parashikueshmëria janë një pjesë e pandarë e sundimit të ligjit.

Ndërsa sa i përket ekzekutimit të vendimit të formës së prerë, sistemi juridik i Kosovës ende sot e tutje, është duke dështuar të realizojë të drejtën e Hysni Selmanaj për kthim në vendin e punës. E drejta për të përmbartuar një vendim gjyqësor i formës së prerë është pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Është i parëndësishëm fitimi i një të drejtë nëse një e drejtë e tillë nuk realizohet.

Hysni Selmanaj sot e kësaj dite, nuk është kthyer në vendin e tij të punës.

Zvarritja e vazhdueshme e procesit gjyqësor prej dy dekadash në rastin ku qytetari e konteston pronën në të cilën jeton ish- ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha.

Gjykata Themelore në Pejë

Nr i lëndës: C.nr.771/17

Paditës: Ibrahim Fazliu

I paditur: Rrustem Berisha dhe Komuna e Pejës

Data e paraqitjes së padisë: 11.10.2000

Paditësi Ibrahim Fazliu në vitin 2000 ka paditur ish-ministrin e Mbrojtjes (FSK), Rrustem Berisha dhe Komunën e Pejës sepse pretendon se kundërligjshëm i është marrë e drejta e shfrytëzimit të pronës në Pejë, me sipërfaqe prej mbi katër ari dhe i është bartur ish komandantit të UÇK-së dhe ish-ministrit të FSK-së.

Sipas tij, Kuvendi Komunal i Pejës, më 12 nëntor të vitit 1999, kishte marr vendim që këtë pronë t'ia jep në shfrytëzim të përhershëm Berishës dhe se në rastin konkret kemi të bëjmë me pasuri private, e cila si e tillë në asnjë mënyrë, nuk ka mundur të jepet në shfrytëzim nga Komuna e Pejës të paditurit Berisha. Për këtë çështje juridiko-civile, padia e parë ndaj të paditurve të njëjtë, është ushtruar në vitin 2000, për të njëjtën bazë juridike, nga Hysen Fazliu, vëllai i tani paditësit, Ibrahim Fazliu. Sa i përket kësaj kërkesë, dy herë është vendosur nga gjykatat në nivel të shkallës së parë dhe të dytë.

Lidhur me padinë e parë, më 19 shtator 2001, ish-Gjykata Komunale në Pejë, nxori aktvendim me të cilin e kishte aprovuar propozimin e të paditurit Rrustem Berisha, për ndërprerjen e procedurës kontestimore. Ndër të tjera, ish-Gjykata Komunale, ndërprerjen e procedurës e kishte arsyetuar për faktin se mes palëve ndërgjyqëse ishte paraqitur si kontestues, vlefshmëria e aktit të trashëgimisë dhe për këtë çështje vendoset në procedurë jokontestimore.

Kundër këtij aktvendimi, për ndërprerjen e procedurës kontestimore, kishte paraqitur ankesë paditësi, e cila ishte aprovuar nga ish-Gjykata e Qarkut. Vendimi tjetër i radhës, në të cilën gjykata kishte vlerësuar themelësinë e kërkesëpadisë, ishte më 9 maj 2002, me të cilin aktgjykim ishte refuzuar kërkesëpadia e paditësit Hysen Fazliu, me të cilin kërkonte të vërtetohet se është pronar i patundshmërisë nr.5390/23.

Ish-Gjykata Komunale në Pejë, me vendim e saj, paditësit nuk ia kishte njohur të drejtën e pronësisë në bazë aktvendimit mbi trashëgimi, ngase, sipas gjykatës, ky vendim nuk i plotëson as për së afërmi formën e paraparë procedurale për shqyrtimin e trashëgimisë.

Ish-Gjykata e Qarkut në Pejë, me aktvendimin e saj më 11 janar 2006 e kishte prishur aktgjykimin e shkallës së parë, duke e kthyer në rishqyrtim.

Gjykata Themelore në Pejë, më 2 korrik 2017, kishte marr aktvendim, me të cilën kishte hedhur poshtë padinë e paditësit Ibrahim Fazliu si të parregullt. Kjo pasi sipas gjykatës së shkallës së parë, paditësi Fazliu kishte dhënë adresë e të paditurit të parë, por sipas fletëkthesës së kthyer kishte rezultuar nga postierit se “pala jeton në Prishtinë”.

Në bazë të kësaj, gjykata merr vendim sipas të cilit paditësit ia kthen padinë për korrigjim, duke e detyruar që në afat prej tre ditësh, të potencojë adresën e saktë të paditurit Rustem Berisha. Kurse paditësi, sipas gjykatës, si adresë të vendbanimit, prapë, kishte paraqitur adresën e parë, të cilën e kishte theksuar në padi. Si pasojë e kësaj, gjykata kishte hedhur padinë.

Kundër këtij aktvendimi, ishte ushtruar ankesë nga paditësi, ku Gjkata e Apelit, më 13 korrik 2017 e kishte prishur vendimin e shkallës së parë, duke e kthyer rastin në rishqyrtim.

Gjkata e Apelit ka theksuar se gjykata e shkallës së parë, pas dorëzimit të parashtresës për plotësim të padisë, nuk ka provuar që të njëjtën t'ia dorëzojë të paditurit Rustem Berisha, pavarësisht, së është prezantuar adresa e njëjtë.

Gjatë monitorimit sistematik të këtij rasti, IKD ka analizuar dhe vlerësuar rrjedhjen procedurale dhe materiale të këtij rasti dhe respektimin e afateve ligjore nga ana e gjykatës dhe si rrjedhje IKD ka gjetur se procedura civile në rastin ku i paditur është ish- ministri i FSK-së manifestohet me zvarritje të theksuara të procedurës dhe këto zvarritje po vazhdojnë në Gjykatën Themelore të Pejës.

Ky rast është karakterizuar me caktimin e seancave duke i tejkaluar afatet ligjore, ashtu që seancat shtyhen në kohëzgjatje më shumë se tre muaj, përkundër asaj se afati ligjor është një muaj.

IKD ka gjetur se pas seancës së 5 shtator 2018, seanca tjetër ishte caktuar më 21 nëntor 2018, apo pas 3 muaj e 12 ditë. Po ashtu, pas seancës së 21 nëntorit 2018, seanca e radhës ishte caktuar me 24 janar 2019, gjegjësisht pas 2 muajve e 3 ditëve. Ngjashëm, pas seancës së 24 janarit 2019, seanca tjetër ishte caktuar me 14 mars 2019 apo pas 1 muaji e 18 ditëve, kurse seanca tjetër pas asaj të 14 marsit 2019 ishte caktuar me 19 qershor 2019, apo pas 3 muajsh e 5 ditë. Seanca e radhës ishte mbajtur pas më shumë se tre muaj gjegjësisht me 10 tetor 2019. Pas seancës së 10 tetorit 2019, seanca tjetër ishte caktuar më 24 dhjetor 2019, pra pas më shumë se dy muajve. Kurse seanca tjetër ishte caktuar më 12 mars 2020 apo pas 2 muaj e 17 ditëve.

Pas seancës së 12 marsit 2020, seanca tjetër ishte caktuar tek më 7 maj 2020, ndërsa në seancën e 12 marsit 2020, gjykata kishte filluar të administroj provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, mirëpo nuk ishin lexuar të gjitha provat. Në këtë seancë, gjykatësja Afërdita Mulhaxha kishte hasur në disa prova të cilat nuk mundi t'i lexojë, si certifikata e vitit 2000 dhe një shkresë e vitit 2017 e Kuvendit Komunal Pejë, të cilat janë kopje, e të cilat prova gjendjen në një lëndë tjetër, për çka mori vendim që t'i sigurojë.

Neni 441 i Ligjit të Procedurës Kontestimore përcakton se *“Seanca kryesore dëgjimore nuk mund të shtyhet më shumë se tridhjetë (30) ditë, përveç rasteve të përcaktuara me ligj. Në qoftë se shtyhet seanca, gjyqtari ka për detyrë që t'i merr të gjitha masat e mundshme me qëllim që të hiqen shkaqet që e kanë shkaktuar shtyrjen, si dhe me qëllim që në seancën e ardhshme të përfundoj normalisht shqyrtimi i çështjes”*.

Po ashtu në këtë rast, Gjkata e Pejës nuk kishte marrë përsëri asnjë masë efektive të disponueshme ligjërisht me qëllim që palët në procedurë të mos e zvarrisin procesin

kontestimor, për faktin se Komuna e Pejës në vitin 2019 ishte urdhëruar dy herë nga gjykata që t'ia sjellë dokumentacionin përkatës me të cilën do të vlerësohej nëse Komuna e Pejës ka përfillur procedurat ligjore për dhënien në shfrytëzim të tokës kontestuese. Mirëpo ky urdhër i gjykatës nuk është marrë parasysh nga Komuna e Pejës dhe e njëjta nuk ka siguruar shkresat për të cilat është detyruar nga gjykata, ndërsa gjykata në anën tjetër nuk ka marrë asnjë masë ligjore ndaj palëve në procedurë për të ndaluar çdo keqpërdorim të drejtave në procedurë të cilat ndikojnë në shkaktimin e vonesave dhe tejzgjatje të procedurave.

Dështimi për të siguruar pagat e parealizuara të punëtorit tani të pensionuar nga sistemi gjyqësor i Kosovës.

Gjykata Themelore në Pejë

Nr. i lëndës: C.nr.257/11

Paditës: Valdet Nikçi

E paditur: Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP)

Kontesti: Kompensim dëmi

Data e paraqitjes së padisë: 27 maj 1997

Valdeti Nikçi, ish-punëtor në ndërmarrjen shoqërore “Fabrika e Konstruksioneve Metalike” në Pejë, e cila fabrikë tani është nën menaxhimin e AKP-së, më 27 maj 1997, kishte ngritur padi ndaj kësaj ndërmarrje për kompensimin e tri pagave personale nga marrëdhënia e punës.

Padia në fjalë ishte ngritur në ish-Gjykatën Komunale në Pejë.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Më 27 tetor 2004, ish-Gjykata Komunale në Pejë, kishte aprovuar si të bazuar kërkesën për kompensim e pagave dhe kishte detyruar AKP-në që paditësit t’ia paguajë pagat mujore të papaguara, prej 1 qershorit 1995 deri më 31 mars 1999.

Vendimi i Gjykatës Komunale ishte bërë i formës së prerë. Por, më 30 prill 2010, AKP -ja parashtrroi kërkesë për përsëritje të procedurës. Më 20 prill 2011, shkalla e parë e Gjykatës së Qarkut, anuloi Aktgjykimin të ish-Gjykatës Komunale në Pejë dhe lejoi përsëritjen e procedurës.

Me reformimin e sistemit gjyqësor më 1 janar 2013, ky rast ka kaluar në Gjykatën Themelore të Pejës. Kjo Gjykatë filloi të shqyrtojë rastin, dhe e njëjta më 8 shkurt 2016, e kishte pezulluar shqyrtimin e procedurës kontestimore deri në përfundimin e procedurës së likuidimit.

Si pasojë e pezullimit të procedurës për shqyrtimin e padisë së paditësit për kompensimin e pagave, paditësi i ishte drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës me pretendimin se të njëjtit i’u ishin shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Gjykata Kushtetuese kishte vendosur se pezullimi i pacaktuar i procedurës e privon parashtruesin e kërkesës nga një vendim përfundimtar lidhur me kërkesën e tij për pagimin e pagave të papaguara dhe si rrjedhojë me pezullimin e procedurës civile është shkelur nenit 31 (2) i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së. Pasi rasti ishte kthyer në Gjykatën Themelore në Pejë, e njëjta ishte shpallur jokompetente në aspektin lëndor, duke e konsideruar veten jokompetente për të vendosur për çështjet pagave të punorëve nga ndërmarrjet shoqërore.

Pretendimet e paditësi Valdet Nikqi për kompensimin e pagave prej 1997, edhe më tutje janë duke u zhvilluar në Gjykatën Themelore në Pejë, ndërsa rasti është përmes mjeteve të ankimit në Gjykatën Supreme.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Sa i përket trajtimit të këtij rasti nga sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës, ky rast paraqet në mënyrë të hapur pazotësinë e sistemit gjyqësor për t'i dhënë epilog rastit në fjalë. Gjykatës mund t'i atribuohen tri shkelje flagrante me të cilat është ballafaquar paditësi Valdet Nikqi. Shkelja e parë konsiston me përmbysjen e një vendimi të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm i cili ishte në favor të paditësit, por gjykata e shkallës së parë pas paraqitjes së propozimit për përsëritje të procedurës nga AKP, e njëjta kishte prishur një vendim të formës së prerë dhe të favorshëm për paditësin.

Gjykata e Pejës përpos që kishte përmbysur një vendim të formës së prerë, kishte marrë vendim që të pezullojë përkohësisht procedurën kontestimore dhe zvarritja e vazhdueshme që dëmton të drejtat individuale të paditësit dhe ndikon në uljen e besimit të qytetarëve në Gjykata.

Sipas praktikës së GJEDNj-së periudha e llogaritjes për zgjidhjen e një rasti gjyqësor fillon prej ditës kur qytetarët kanë paraqitur padinë në gjykatën kompetente.

Që nga parashtrimi i padisë e deri më 24 prill 2020 kanë kaluar hiq më pak se 8 mijë 368 ditë, apo mbi 22 vite e shtatë muaj.

Gjatë tërë kësaj periudhe, paditësi nuk ka mundur që të marrë një përgjigje definitive nga sistemi gjyqësor. Për më tepër, sistemi gjyqësor këtij rasti nuk i kishte dhënë një epilog as pasi Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës pezullimin në kohë të pacaktuar e kishte konsideruar si kundër kushtetues.

IKD rikujton të gjithë akterët institucional të përfshirë në këtë rast, por edhe në raste të tjera të ngjashme, se gjykimi në kohë të arsyeshme është një nga 3 elementet që sipas KEDNj-së përbën të drejtën për një proces të rregullt. Në shumicën dërrmuese të rasteve, në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës nuk ka pasur mundësi që të zbatohet kjo e drejtë e qytetarëve, derisa arsyet kanë qenë të natyrave objektive dhe subjektive. Por, rasti në fjalë në të cilin padia është ende pa një epilog që nga viti 1997 nuk mund të arsyetohet me asnjë faktorë, por mund të cilësohet si dështim i pastër i sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Andaj, IKD rekomandon që këtij rasti dhe rasteve të tjera me natyrë të ngjashme t'i jep një trajtim meritator dhe profesional, derisa KGJK të mbajë përgjegjësinë për shkelje potenciale disiplinore akterët që kanë ndikuar që ky rast ende të jetë pa përgjigje.

Gjykata e Prishtinës e gjykon në afat rekord kontestin e ish-shefit të Krimeve Ekonomike Nazim Sahiti për t'u kthyer në vendin e tij të punës.

Gjykata Themelore në Prishtinë

Nr i lëndës: 3586/18

Paditës: Nazim Sahiti

E paditur: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës.

Data e paraqitjes së padisë: 07.12.2018

Kontesi: Kthim në vendin e punës

Në këtë rast, paditësi Nazim Sahiti, sipas padisë së ushtruar më 7 dhjetor 2018, ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, që ta anulojë vendimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, me të cilin ai ishte shkarkuar nga pozita e drejtorit të Drejtorisë së Hetimeve të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Policinë e Kosovës, duke kërkuar gjithashtu që të kthehen në vendin e tij të punës.

Për të arritur deri tek përfundimi i kësaj rasti, Gjykata Themelore në Prishtinë ka mbajtur vetëm dy seanca gjyqësore, të cilat që të dyja ishin caktuar brenda muajit mars 2019, atë më 6 mars dhe 25 mars 2019. Ndërsa pas përfundimit të kontestit më 25 mars 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë pas 18 ditëve ka marrë vendim me të cilën e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit Nazim Sahiti dhe e ka kthyer në vendin e tij të mëparshëm të punës, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Ndaj këtij vendimi, Policia e Kosovës ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, më 16 maj 2019 mirëpo e njëjta nuk ka vendosur ende për këtë rast.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

IKD vlerëson dhe vazhdimisht kërkon që rastet të trajtohen në kohë të arsyeshme dhe mirëpret rastet që përfundojnë brenda një afati të arsyeshëm si në rastin konkret, mirëpo duke pasur parasysh se kemi shumë raste tjera të cilat zvarriten me dekada e vite të tëra, në raport më këtë rast civil, shpërfaq se sistemi gjyqësor në Kosovë është sistem selektiv.

Janë një numër jashtëzakonisht i madh i lëndëve, prej tyre edhe lëndë me prioritet, të cilat nuk zgjidhen për vite nga gjyqësori i Kosovës, derisa në këtë rast është vepruar me urgjencë. Në këtë mënyrë, secili qytetar i Republikës së Kosovës, i cili për rastin e tij ka pritur me vite gjyqësorin, këtë rast e sheh si trajtim selektiv nga gjykata, i cili fakt ndikon në uljen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Administrimi jo efikas i drejtësisë nga Gjykata Themelore në Prishtinë në rastin e 17 paditësve të cilët kërkuan të kthen në vendin e punës.

Gjykata Themelore në Prishtinë

Nr i lëndës: C.nr.3243/14

Paditës: Sadri Gashi, Naser Metolli, Qamil Maqedonci etj.

I paditur: Ndërmarrja shoqërore “Victory”

Data e paraqitjes së padisë: 02.12.2014

Kontesti: Kthim në vendin e punës

Ish 17 punëtorët e Hotel “Victory” Sadri Gashi, Naser Metolli, Qamil Maqedonci, Qamil Morina, Fehmi Ismajli, Ahmet Kokolli, Afrim Qyqalla, Ardian Gashi, Florim Shala, Driton Rexha, Granit Mehmeti, Fatlum Jashari, Qamil Bllaca, Valon Arifi, Arsim Zejnullahu, Nuhi Ejupi dhe Ismet Metolli, më 31 gusht 2014 ishin larguar nga puna.

Ndaj këtij vendimi, të njëjtit më 2 mars 2017 kishin paraqitur padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Sipas padisë, largimi nga puna ishte bërë me urdhër verbal të pronarit të NSH “Victory”, Blerim Vitija, i cili në mënyrë të njëanshme iu kishte ndërprerë marrëdhënien e punës pa kurrfarë sqarimi. Më 4 dhjetor të vitit 2014, gjykata kishte marrë në trajtim rastin e tyre me ç’rast ishin mbajtur 10 seanca gjyqësore. Këto seanca gjyqësore vazhduan të mbahen duke thirrur dëshmitarë dhe ekspertë deri më 10 qershor 2018 kur gjyqtarja e rastit, kishte marrë vendin për hudhjen poshtë të padisë duke e cilësuar të njëjtën si të pasafatshme.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

IKD vlerëson se trajtimi i rastit të ish-punëtorëve nuk ishte bërë në përputhje me Ligjin për Procedurën Kontestimore, respektivisht nuk ishte trajtuar në harmoni me parimin e efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës kontestimore. Fakti se Gjykata Themelore në Prishtinë ka mbajtur 10 seanca gjyqësore duke dëgjuar dëshmitarë dhe duke thirrur ekspert në shqyrtim gjyqësor, kjo tregon se gjykata ka anashkaluar fazën e parë të analizimit dhe shqyrtimit paraprak të padisë e cila është fazë fillestare në të cilën vlerësohen padia e palëve nëse ajo është e rregullt në aspektin në procedural dhe material.

Çështja e vlerësimit të afatshmërisë së kërkesëpadisë duhet të realizohet në fazën paraprake të shqyrtimit të padisë dhe kjo fazë mundëson që një proces gjyqësor të administrohet pa vonesa dhe vetëm paditë të cilat janë të rregullta ligjërisht të procedohen në shqyrtim gjyqësor. Për shkak të mënyrës së tillë të veprimit, në gjykatë janë mbajtur një numër i madh i seancave, ndonëse sipas gjykatës, kërkesa kishte qenë e pasafatshme.

IKD vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me administrim jo të mirë të drejtësisë. Në pothuajse secilën procedurë gjyqësore, parimi i ekonomizimit të procedurës si parim i përgjithshëm sendërtohet me dispozita të veçanta, që mundësojnë zbatimin në praktikë të këtij parimi.

Në rastin konkret, si dispozitë e veçantë është rregulli për shqyrtimin paraprak të padisë, filter ky i cili në rastin konkret ka dështuar të zbatohet nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Sfida e sistemit gjyqësor për të konstatuar nëse rasti është “çështje e gjykuar”

Gjykata Themelore në Pejë

Nr i lëndës: C.nr.190/17

Paditës: Shoqata Komunale e të Verbërve në Istog

I Paditur: Sadri Nicaj

Data e paraqitjes së padisë: 5 janar 2006

Kontesti: Lirim nga Patundshmëria

Para 14 vitesh Shoqata Komunale e të Verbërve në Istog kishte nisur betejën ligjore përmes ushtrimit të padisë në ish-Gjykatën Komunale të Istogut ndaj të paditurës Have Nicaj, duke kërkuar që e paditura të liroj hapësirën dy dhomëshe, të cilën sipas paditëses e paditura e kishte uzurpuar

Kjo paluajtshmëri në të cilën po kërkohet lirimi i saj, sipas Shoqatës së të Verbërve, është në funksion të pushimores të personave të verbër e që mbi 35 vite ishte uzurpuar nga e paditura Have Nicaj, ndërsa pas vdekjes së saj, në cilësinë e të paditurit është përfshirë Sadri Nicaj.

Në këtë rast, nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë janë marrë më shumë se pesë vendime gjyqësore.

Fillimisht, ish-Gjykata Komunale në Istog më 19 qershor 2006, kishte hedhur poshtë padinë e Shoqatës së të Verbërve për shkak se kishte vlerësuar se ishte çështje e gjykuar.

Si të paligjshëm dhe në shkelje të procedurës kontestimore këtë vendim gjyqësor të Gjykatës së Istogut e kishte cilësuar ish-Gjykata e Qarkut, e cila më 5 shkurt 2007 kishte anuluar vendimin e mësipërm.

Gjykata e Qarkut kishte arsyetuar se gjykata e shkallës së parë kishte gabuar kur kishte konstatuar se rasti kontestimor i Shoqatës ishte i gjykuar.

Pasi çështja kontestimore ishte kthyer në rivendosje, më 11 mars 2008 ish-Gjykata e Qarkut kishte aprovuar pjesërisht padinë e Shoqatës së të Verbërve duke vërtetuar se janë pronarë të paluajtshmërisë - ngastrës ngadastrale 4/82 me kulturë shtëpi dhe oborr me sipërfaqe prej 0.5 hektar, mirëpo kishte refuzuar kërkesën e Shoqatës që e paditura Have Nicaj t’ia lirojë katin e dytë të shtëpisë, në të cilën si pronare evidentohet Shoqata e të Verbërve. Ky vendim përsëri ishte prishur nga ish-Gjykata e Qarkut më 21 maj 2009.

Kjo gjykatë kishte arsyetuar se aktgjykimi i ish-Gjykatës Komunale nuk ishte i drejtë dhe i ligjshëm për shkak se paditëses iu është njohur e drejta e pronësisë, mirëpo përkundër kësaj është refuzuar që e njëjta t’i dorëzohet në posedim.

Ndërsa, përsëri ish-Gjykata Komunalë në Istog më 27 tetor 2011 kishte hudhur padinë e Shoqatës së të Verbërve si të palejuar, duke arsyetuar se ishte çështje e gjykuar.

Ankesë kundër këtij aktvendimi kishte ushtruar paditësja, e cila kishte kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë të anulojë këtë vendim për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore. Duke vepruar në bazë të kësaj ankesë, ish-Gjykata e Qarkut kishte refuzuar ankesën e Shoqatës së të Verbërve si të pabazuar dhe kishte vërtetuar aktvendimin e ish-Gjykatës Komunale në Istog. Por, këtë aktgjykim më 24 dhjetor 2013 e kishte prishur Gjykata Supreme, sipas të cilës aktgjykimi në fjalë ishte mbështetur në aktvendime jo të plotfuqishme dhe si tilla cilësohen inekzistente.

Pasi rasti ishte kthyer në rigjykimin, ish-Gjykata Komunale në Istog përsëri kishte vendosur që të hudhë padinë e paditëses si të palejuar pasi sipas kësaj gjykatë për këtë çështje ishte vendosur me vendim të formës së prerë nga po e njëjta gjykatë.

Pas këtij vendimi, tashmë i pesti me radhë, kjo çështje kontestimore ishte deleguar në Gjykatën Themelore në Pejë, me kërkesën e Shoqatës Komunale të të Verbërve e cila tani gjendet në fazën e shqyrtimit gjyqësor.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Në këtë rast, Shoqata Komunale e të Verbërve në Istog është privuar nga e drejta e tyre që rasti i tyre të marrë epilog brenda një kohe të arsyeshme.

Por, kjo nuk ka ndodhur për arsye objektive, përkatësisht për shkak të numrit të madh të lëndëve dhe numrit të vogël të gjyqtarëve, por për shkak se për të njëjtën çështje, asnjë shkallë e gjyqësorit nuk ka mundur të vendosë.

Zvarritja e procedurës nuk ka ndodhur as për shkak të kompleksitetit të çështjes, apo numrit të lartë të provave, apo zvarritja nuk mund t'i atribuohet sjelljes së palëve, për arsyeje se gjykata disa herë ka dështuar të vendos për themelësinë e kërkesëpadisë duke e shqyrtuar atë vetëm nga aspektet procedurale.

Në këtë rast, lënda më së shpeshti është kthyer në rigjykim për shkak të dilemave të hallkave gjyqësore lidhur me definimin e “çështjes së gjykuar” në rastin konkret. Po ashtu, një nga vendimet ishte prishur pasi gjykata nuk kishte arritur që të përcaktonte legjitimacioni aktiv, përkatësisht faktin se kush është palë në procedure.

Lidhur me këtë situatë, IKD vlerëson se për pothuajse të gjitha çështjet është normale që të ketë dilema në gjyqësor. Por, këto dilema nuk duhet të mbesin të pazgjdhura në mes të gjyqësorit dhe në dëm të interesave të qytetarëve. Për të qartësuar këto çështja, sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës ka përcaktuar hierarki në sistemin gjyqësor, Në këtë mënyrë, edhe Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme nuk duhet që thjesht të konstatojnë gabimet dhe rastet të kthejnë në rigjykim, por duhet të vendosin standarde dhe të qartësojnë dilema. Nëse pas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit gjykatat e shkallës së parë nuk veprojnë në këtë mënyrë, atëherë është përgjegjësi e KGJK-së që të veprojnë sipas ashtu siç kërkohet me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Kjo çështje civile ende është duke u gjykuar në Gjykatën Themelore në Pejë, ndërsa shqyrtimi kryesor në këtë rast ka përfunduar

në muajin Janar të vitit 2020, mirëpo deri më tani aktgjykimi në këtë rast ende nuk është përpiluar nga Gjykata Themelore në Pejë.

Mos përpilimi brenda afatit ligjor krijon zvarritje të mëtutjeshme për palët ndërgjyqësore në këtë proces civil, që po zhvillohet tani e 13 vite.

Neni 153 i LPK-së përcakton se *“Gjykata e jep aktgjykimin më së voni brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e përfundimit të shqyrtimit kryesor. Koha në të cilën jepet aktgjykimi quhet dita në të cilën ai hartohet me shkrim”*.

“Ping Pongu” i sistemit gjyqësor më rastin qytetares Afërdita Statovci për të drejtën e saj në trashëgimi.

Gjykata Themelore në Prishtinë

Nr i lëndës: C.nr.1523/19

Paditës: Afërdita Statovci

I Paditur: Muharrem Haxhia

Data e paraqitjes së padisë: 27 shkurt 2006

Kontesti: Njohja e të drejtës së pronësisë në bazë të trashëgimisë

Para 14 vitesh paditësja Afërdita Statovci pasi vdekjes së babait të saj dhe pas dëbimit nga shtëpia nga axha i asaj ajo kishte nisur betejën ligjore përmes ushtrimit të padisë në ish-Gjykatën Themelore në Prishtinë, ndaj të paditurve Nazif Berisha dhe Lutfi Statovci, por të cilët i përfaqëson Muharrem Haxhia, bartjen e pronësisë dhe përcaktimit të së drejtës në pjesën e patundshmërisë.

Kjo patundshmëri e cila po kërkohet nga paditësja Statovci, sipas saj ishte blerë nga babai dhe axha saj, ku e njëjta ishte shfrytëzuar nga të dy vëllezërit në bashkëpronësi, ndërsa pas vdekjes së babait të paditëses, prona është shfrytëzuar vetëm nga i padituri Haxhi Statovci, axha i paditëses, edhe pse ajo ka qenë trashëgimtarja e vetme, të njëjtës nuk i është dhënë pjesa të cilën i padituri sipas kontratës ka pasur obligim që t’ia bartë asaj.

Ndryshe ky rast ishte kthyer dy herë në rigjykim, duke e zvarritur këtë procedurë për 13 vite.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Fillimisht ish-Gjykata Komunale në Prishtinë më 26 qershor 2009, kishte aprovuar kërkesa e paditëses Afërdita Statovci, ashtu që është vërtetuar se e njëjta është pronare e paluajtshmërisë lëndore, e cila gjendet në fshatin Sllatinë e Madhe, Komuna e Fushë Kosovës, vendi i quajtur “Selo-selo”, me sipërfaqe prej 657 m², si dhe ngastrës kadastrale 361 m², si dhe paluajtshmërisë, që gjendet në Harilaq, Komuna e Fushë Kosovës, me sipërfaqe prej 1.08.74 ha.

Mirëpo ish-Gjykata e Qarkut në Prishtinë, më 2 qershor 2010, e kishte kthyer në rigjykim me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë, gjatë procedurës së zhvilluar në këtë çështje kontestuese, kishte bërë shkelje qenësore nga dispozitat e nenit 182 al. 2, pika n, të LPK-së.

Pas kthimit në rigjykim, Gjykata Themelore në Prishtinë, më 23 shtator 2016, ka aprovuar tani për të dytën herë kërkesën e paditëses Afërdita Statovci, duke vërtetuar se ajo nga baza e trashëgimisë është pronare e ½ e pjesës ideale te paluajtshmërisë lëndore, e cila gjendet në fshatin Sllatinë e Madhe.

Por, ky vendim i nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, ishte kthyer në rishqyrtim dhe vendosje nga Gjykata e Apelit e Kosovës, më 2 maj 2019, me arsyetimin se qëndrimi dhe vendimi i shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që siç thuhet në aktvendim,

aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore nga neni 182 par. 2 pika n), e LPK-së, po ashtu sipas kësaj gjykate gjendja faktike nuk ishte vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për të cilën arsye ka ardhur deri të të zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.

Pas kthimit në pikën zero të rastit i cili ishte bërë më 2 maj 2019, seanca ishte paraparë të mbahej më 23 tetor 2019, mirëpo e njëjta kishte dështuar të mbahet për shkak të mungesës së gjykatëses, për të cilën zyrtarja e saj ligjore kishte thënë se e njëjta tash e tre javë gjendej në pushim mjekësor.

E për këtë përfaqësuesi i paditëses kishte thënë se nuk kishte marrë asnjë lajmërim që kjo seance nuk do të mbahet, edhe pse ky rast ishte duke u zvarritur tash e 13 vjet, po ashtu i njëjti e kishte lajmëruar zyrtaren ligjore të gjykatëse se paditësja dhe i padituri kishin arritur një marrëveshje.

Pas kësaj seanca e radhës ishte mbajtur më 11 dhjetor 2019, ku paditëses Statovci i ishte njohur e drejta e pronës në bazë të trashëgimisë, ku ajo dhe i padituri Muharrem Haxhia, kishin arritur pajtim gjyqësor lidhur me këtë kontest.

Në këtë rast paditësja Afërdita Statovci është privuar nga e drejta e saj që rasti i saj të marrë epilog brenda një kohe të arsyeshme. Detyrimet të cilat janë të mishëruara nga sistemi gjyqësor përmes nenit 6 të KEDNJ kërkojnë që sistemi të sigurojë mekanizma efikas në mënyrë që palët t'i realizojnë të drejtat e tyre brenda afatit të arsyeshëm kohor. Përfitimet të cilat i ka pasur paditësja nga neni 6 që garantohen nga Konventa, nuk u zbatuan nga sistemi juridik i Kosovës për faktin se gjykatat në mënyrë të vazhdueshme kanë zhvilluar lojën e “ping pongut”, në rastin e paditëses duke e kthyer disa herë rastin në rigjykim.

Në rastin e paditëses, nuk ka ekzistuar ndonjë arsyeje objektive që ka justifikuar kohëzgjatjen e procedurës kontestimore dhe sjellja e gjykatës ka bërë që e drejta për gjykim brenda një kohe të arsyeshme të shkelet, duke marrë bazë faktin se në rastin e paditëses ishin ndërruar 16 gjykatës për 13 vite dhe dy herë prishje të vendimeve nga gjykata e instancës më të lartë.

Një gjykim i tillë nëpër të cilin ka kaluar paditësja Statovci mund të konsiderohen i anshëm jo i drejtë dhe në shkeljen e parimeve kushtetuese të cilat janë bazë për funksionimin e një sistemi gjyqësor, ku qytetarët përderisa pritet të ballafaqohen në gjykatë me palët ndërgjyqësore, ata duhet të ballafaqohen me padrejtësitë e sistemit gjyqësor.

Gjykata po ashtu, nuk ka përfillur rekomandimet e Avokatit të Popullit, që lëndët e tilla që kthehen në rigjykim të mos marrin numër të ri dhe të nisin nga zero, por të konsiderohen lëndë të vjetra prej momentit kur janë paraqitur, sepse në të kundërtën zvarritjet dekadëshe sikurse në këtë rast, do të dekurajojnë gratë e tjera që të kërkojnë të drejtën e trashëgimisë së pronës.

Mbi shtatë (7) vite për caktimin e seancës përgatitore

Ish-Gjykata Komunale në Prishtinë

Nr i lëndës: C.nr.2579/12, C.nr.2853/13, C.nr.2440/13, C.nr.2727/13

Paditës: Abedin dhe Refki Mehana, Fadil Hoxha, Smajl dhe Naile Maxhuni, Imer Rrahmani

I Paditur: Kompania e sigurimeve “Insig, Siguria, Kosova e re” Prishtinë

Data e paraqitjes së padisë: 2 tetor 2012, 30 tetor 2013, 25 shtator 2013, 14 tetor 2013

Kontesti: Kompensim dëmi

Paditësit e lartcekur, kanë vetëm një gjë të përbashkët. Ata kanë rënë viktimë e shkeljes së të drejtës për të pasur një gjykim afati të arsyeshëm, kur sistemi juridik ka dështuar që të caktojë seancën përgatitore në harmoni me ligjin.

Në këtë rast paditësit Abedin dhe Refki Mehana, sipas padisë së ushtruar në tetor të vitit 2012, kanë kërkuar nga ish-Gjykata Komunale në Prishtinë, që t’i detyroj të paditurat që atyre t’ia kompensoj dëmin e shkaktuar në aksident trafiku i cili kishte ndodhur në qershor të vitit 2012.

Në këtë rast shqyrtimi kryesor është mbajtur më 3 dhjetor 2019, ku edhe ishte dhënë fjala përfundimtare e palëve ndërgjyqëse.

Fillimisht në këtë rast seanca përgatitore ishte caktuar më 26 mars të vitit 2019, që do të thotë gjykatës i është dashur shtatë vite deri në caktimin e seancës përgatitore.

Paditësi Fadil Hoxha kishte ushtruar padi në tetor të vitit 2013, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, i cili përmes saj ka kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën kompaninë e sigurimeve “Kosova e Re”, që atij t’ia kompensoj dëmin e shkaktuar në aksident trafiku që kishte ndodhur në tetor të vitin 2012.

Ky rast ka përfunduar më 23 maj të viti 2019, dhe atë me pajtim gjyqësor mes palëve ndërgjyqëse, të cilin vendim e ka aprovuar gjykatësja pasi që palët ndërgjyqëse kishin shprehur vullnet që këtë rast ta përfundojnë me pajtim gjyqësor.

IKD gjatë monitorimit të këtij rasti ka vërejtur se seanca përgatitore ishte caktuar më 14 nëntor të vitit 2018, që do të thotë gjykatës i është dashur plot pesë vite deri në caktimin e seancës përgatitore.

Paditësi Imer Rrahmani kishte ushtruar padi më 30 tetor të vitit 2013, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, pasi që i njëjti sipas padisë kishte pësuar lëndime të rënda trupore gjatë orarit të punës, ku kishte kërkuar nga gjykata që ti detyroj të paditurat që atij t’ia kompensojnë dëmin e shkaktuar si pasojë e lëndimit në punë.

Edhe në këtë rast civil, IKD ka vërejtur një zvarritje të theksuar të caktimit të seancës përgatitore, për faktin se seanca përgatitore ishte caktuar më 6 qershor të viti 2018, ndërsa paditësi u ishte drejtuar gjykatës për të kërkuar kompensimin e dëmit, në tetor 2013.

Një rast tjetër që është karakterizuar me një mungesë efikasiteti për caktimin e seancës përgatitore është edhe rasti i paditësve Ismajl dhe Naile Maxhuni, të cilët kishin ushtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë më 25 shtator 2013, ku kishin kërkuar nga gjykata që ta detyroj kompaninë e sigurimeve “Kosova e re”, që atyre t’ia kompensoj dëmin material dhe jo material të shkaktuar si pasojë e aksidentit i cili kishte ndodhur në shkurt të vitit 2013.

Në këtë rast seanca përgatitore ishte mbajtur më 12 shtator 2019, ndërsa më 5 nëntor 2019, palët ndërgjyqëse ishin dakorduar që këtë çështje ta mbyllin me ujdë gjyqësore, me arsyetimin se nuk dëshironin që të krijonin më shumë shpenzime, pasi që kishte kaluar një kohë shumë e gjatë që nga paraqitja e padisë, e këtë marrëveshje e kishte aprovuar gjykatësja e rastit.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

Mos caktimi i seancave përgatitore apo fillestare me kohën e paraparë ligjore cenon rëndë ligjshmërinë e procedurës kontestimore e cila ka paraparë afate strikte me qëllim të rritjes së efikasitetit të gjykatës ndërsa palëve ndërgjyqësore nuk i lejon të përfitojnë nga të drejtat e tyre për gjykim të drejtë dhe të shpejtë. Një praktikë e tillë cenon rëndë besueshmërinë e publikut në sistemin gjyqësor pasi që sistemi juridik duhet të ketë trajtim adekuat dhe të barabartë ndaj çdo personi fizik dhe juridik që pretendojnë të drejtat e tyre dhe gjykata duhet të maksimum të angazhohen në trajtimin e drejtë dhe efikas të kërkesave të palëve.

Seanca përgatitore sipas Ligjit të Procedurës Kontestimore duhet të caktohet brenda afatit prej 30 ditësh, kurse në rastin konkret është mbajtur pas 7 vitesh. Kjo situatë e cila është e shpeshtë në sistemin tonë, tregon pazotësinë e gjykatës për të trajtuar në mënyrë efektive dhe efikase të drejtat e qytetarëve brenda kornizave ligjore dhe kushtetuese.

Ligji i Procedurës Kontestimore ka përcaktuar se *“Po që se i padituri nuk ka paraqitur përgjigje në padi, e nuk janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit kontumacional, gjykata do ta konvokojë seancën përgatitore pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e përgjigjes në padi”*

LPK ka paraparë afate të shkurtra procedurale në mënyrë që palët në procedurë kontestimore të drejtat e tyre t’i realizojnë me efikasitet. Si rrjedhojë e kësaj, nëse i padituri nuk paraqet përgjigje në padi brenda afatit prej 15 ditësh, pas pranimit të padisë dhe shkresave të tjera, atëherë gjykata duhet të caktojë seancën përgatitore brenda afatit prej 15 ditëve. Gjykata është e detyruar të kujdeset për zbatimin në përpikëri të procedurës kontestimore në mënyrë që palët të realizojnë të drejtat e tyre subjektive civile brenda afatit ligjor.

Gjykatësi e bën “Copy Paste” në procesverbal deklarin e palës së paditur që e kishte dhënë në një rast tjetër.

Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: C.nr.3051/19

Paditës: Avdije Maxhuni

I paditur: Komuna e Prishtinës

Data e paraqitjes së padisë: 06.09.2019

Kontesti: Kompensim i pagave

Paditësja Avdije Maxhuni në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kishte ushtruar padi më 6 shtator 2019, me të cilën ka kërkuar nga Komuna e Prishtinës për kompensimin e pagave jubilarë në shumë prej 1,860.49 euro për përvojën e saj prej 49 viteve si mësimdhënëse.

Gjykata Themelore në Prishtinë, seancën përgatitore të këtij rasti e kishte caktuar më 4 shkurt 2020, pas 5 muaj, respektivisht pas 151 ditëve. Në këtë seancë pas hapjes së gjykimit, përfaqësuesja e Komunës së Prishtinës, Fitore Byqmeti ka kërkuar që të largohet nga zyra e gjykatësit Hysni Bardheci, ku edhe ishte duke u mbajtur gjykimi, duke kërkuar që të gjitha deklarinimet e saj të dhëna në një kontest paraprak, për një rast tjetër, t’i merren si të deklaruara.

Largimi i përfaqësueses Byqmeti nuk e ka penguar gjykatësin Bardheci që të vazhdojë gjykimin për rastin në fjalë, madje duke vepruar sipas kërkesës së saj.

Deklarimet e saj të dhëna në një tjetër rast, gjykatësi Bardheci i ka marrë sikur e njëjta t’i kishte deklaruar vet në seancën e 4 shkurtit 2020, si dhe të njëjtin deklarin e ka lexuar para palës paditëse, kinse përfaqësuesja e të paditurës, Fitore Byqmeti, në seancën e së martës ka deklaruar se nuk është kontestuese se paditësja ka pasur pagën bazë në vlerë prej 421 euro dhe se paditësja ka 39 vjet përvojë pune, duke e kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë. Përpos këtij deklarimi, gjykatësi Bardheci gjithashtu e konstatoi në procesverbal edhe fjalën përfundimtare të përfaqësueses së Komunës, duke e marrë “copy” tërë deklarinimet e saj që ajo e kishte dhënë në një seancë tjetër, për një rast tjetër me pagë jubilarë.

Gjetjet e IKD-s lidhur me trajtimin e rastit:

IKD vlerëson se gjykatësi i rastit Hysni Bardheci ka shkelur Ligjin e Procedurës Kontestimore, në të cilin ligj në nenin 135 thuhet se: “Në procesverbalin e seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes duhet të përfshihet sidomos: nëse seanca është mbajtur me dyer të hapura apo të mbyllura, përmbajtja e deklaratave të palëve, propozimet e tyre, provat që i kanë ofruar, provat që janë shfrytëzuar, duke u treguar përmbajtja e thënieve të dëshmitarëve dhe ekspertëve, vendimet e gjykatës të marra në seancë, por edhe vendimi burimor i dhënë pas përfundimit të seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes juridike”.

Po ashtu, neni 136 i këtij Ligji parasheh se: “Procesverbali duhet të mbahet rregullisht, në të nuk guxon të fshihet asgjë, të shtohet ose të ndryshohet. Pjesët e tij të anuluar duhet të mbeten të lexueshme”.

Rasti i paditësit i cili pas 13 vitesh tërhiqet nga padia për vërtetim pronë, me arsyetimin se tanimë me e ka realizuar atë të drejtë

Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: C.nr.89/06

Paditës: Ismet Mehmeti

I paditur: Muhamet Breca, Mustafë Breca

Data e paraqitjes së padisë: 01.02.2006

Kontesti: Vërtetim pronësie

Paditësi Ismet Mehmet më 1 shkurt 2006, kishte ushtruar padi në ish-Gjykatën Komunale të Prishtinës, tani Gjykata Themelore e Prishtinës, nga e cila kishte kërkuar që të paditurit Muhamet dhe Mustafë Breca, t'ia vërtetojnë të drejtën e pronës kontestuese, e cila gjendet në "Kalabri", Prishtinë, me një sipërfaqe prej 0.07 ha.

Lidhur me rastin e Ismet Mehmetit, IKD ka gjetur se prej ngritjes së padisë më 1 shkurt 2006 e deri në caktimin e seancën përgatitore më 8 tetor 2019, kanë kaluar 13 viteve e 8 muaj e 7 ditë, apo pas 4,997 ditëve. Në seancën përgatitore, paditësi ka deklaruar se pas ushtrimit të padisë kishte lidhur kontratë me shitësit e pronës, të cilën e ka vërtetuar edhe në gjykatë dhe prona kontestuese në këtë padi kishte dal në emër të tij.

Paditësi e ka njoftuar gjykatën se ka paraqitur propozim në procedurën jo kontestimore për ndarjen fizike të pronave ku bashkëpronarë janë rreth 48 persona. "Meqenëse ka filluar procedura për ndarjen fizike, në procedurë jo kontestimore ndërmjet bashkëpronarëve dhe meqenëse për pronën kontestuese tani jam pronar, e tërhiqi padinë e ushtruar më 1 shkurt 2006", ka thënë Mehmeti.³⁰

Gjetjet e IKD-s lidhur me trajtimin e rastit:

Sipas gjetjeve të IKD-së, rasti i Ismet Mehmet, pas 13 viteve pritje në sirtar të gjykatës për të marr një epilog, seanca përgatitore ishte caktuar më 8 tetor 2019, e cila lëndë ishte bartur disa herë nga një gjykatës tek tjetri si dhe ishte shtyrë disa herë për arsye të mungesës së palëve dhe mungesës së gjykatësve.

³⁰ "Tërhiqet nga padia për vërtetim prone, paditësi thotë se tashmë e ka realizuar atë". Betimi për Drejtësi". 8 tetor 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejttesi.com/terhiqet-nga-padia-per-vertetim-prone-paditesi-thote-se-tashme-e-ka-realizuar-ate/>), (Qasur për herë të fundit më 23 nëntor 2020).

Caktimi i seancës përgatitore pas 53 ditëve

Gjykata Themelore Pejë

Nr. i lëndës: C.nr.89/06

Paditës: Mevlude Musiq

I paditur: Xhejlane Berisha

Data e paraqitjes së padisë: 04.02.2019

Kontesti: Vërtetim pronësie

Edhe pse kontestet pronësore në Gjykatat Themelore të Kosovës, zgjasin me vite, në rastin e paditëses Mevlude Musiq nga ngritja e padisë më 4 shkurt 2019, e deri në seanca përgatitore të mbajtur më 29 mars 2019, kishin kaluar vetëm 1 muaj e 25 ditëve, apo 53 ditë.

Me këtë padi paditësja Mevlude Musiq, kishte kërkuar nga e paditura Xhejlane Berisha, të vërtetohet që është pronare dhe poseduese e paluajtshmërisë e cila gjendet në Pejë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 190 metra katror, ndërsa seanca përgatitore e këtij rasti ishte mbajtur 29 mars 2019, respektivisht pas 1 muaj e 25 ditëve.

Ky kontest pronësor kishte përfunduar me aktgjykim në bazë të pohimit, që në seancën përgatitore të 4 shkurtit 2019, pasi që e paditura kishte thënë se është e vërtetë që paditësja Mevlude e ka blerë patundshmërinë që është objekt i kontestit, dhe e njëjta e ka paguar çmimin kontraktues.

Caktimi i seancës përgatitore pas mbi nëntë (9) viteve

Gjykata Themelore Prishtinë

Nr. i lëndës: C.nr.2864/09

Paditës: Zenel Hajdin

I paditur: Jetmir Piliqi

Data e paraqitjes së padisë: 28.12.2009

Lënda e kontestit: Kompensim demi

Ky rast paraqet qasjen e kundërt në raport me rastin paraprak.

Në këtë rast paditësi Zenel Hajdini, sipas padisë së ushtruar më 28 dhjetor 2009, ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, që të detyrohet i padituri Jetmir Piliqi, që t'ia kompensoj shumën e mjeteve financiare të vjedhura në shtëpinë e tij në vlerë prej 3.800.00.

Për këtë rast, i padituri Piliqi, ishte shpallur fajtor për veprën penale të vjedhjes, me vendimin e ish-Gjykatës Komunale në Prishtinë, të datës 5 tetor 2009.

Gjetjet e IKD-s lidhur me trajtimin e rastit

Sipas gjeteve të IKD-së, rezulton se Gjykata Themelore në Prishtinë, lidhur me këtë rast, seancën e parë përgatitore e kishte caktuar më 12 prill 2019, dhe atë pas 9 vite e 3 muaj e 15 ditë, apo pas 3.392 ditëve, ndërsa nga seanca përgatitore e deri në mbajtjen e seancës së shqyrtimit kryesor më 11 korrik 2019, kishin kaluar 2 muajve e 29 ditë, apo pas 90 ditëve, ndërsa vazhdimi i shqyrtimit kryesor ishte përpjekur fillimisht të mbahej më 18 shtator 2019, pra pas 2 muaj e 7 ditë, apo 69 ditëve por e cila seancë kishte dështuar të mbahej si pasojë e mungesës së gjykatësit. Ndërsa seanca e radhës ishte mbajtur më 14 nëntor 2019, përkatësisht pas 1 muaj e 27 ditëve, apo pas 57 ditëve, edhe pse ishte dashur që të gjitha seancat të caktoheshin brenda afatit të paraparë me ligj dhe at brenda 30 ditëve.

Pas katër (4) seancave, Gjykata Themelore në Prishtinë më 26 nëntor 2019, kishte marr vendim me të cilin e kishte aprovuar kërkesëpadinë e paditësit Zenel Hajdini dhe e kishte detyruar të paditurin Jetmir Piliqi që t'ia kompensoj dëmin në vlerë prej 3,800.00 euro.

IKD vlerëson se mos respektimi i afateve ligjore për caktimin e seancave dhe mos futja në punë e lëndëve për vite me radhë, po i detyron palët që të presin 10 vjet ose më shumë për ta realizuar një të drejtë të tyre, si dhe kjo dukuri po ndikon në mosbesim e qytetarëve në punën e gjykatës, dhe shpeshherë po i detyron qytetarët të heqin dorë nga të drejtat e tyre, nga frika se lënda e tyre për shumë vite do të mbesin në gjykatë dhe nuk do të shqyrtohen.

9. Rekomandime

1. Sistemi gjyqësor të angazhohet maksimalisht që lëndët civile të kryhen brenda një afati të arsyeshëm kohor. KGJK ta ketë parasysh faktin se zvarritja e lëndëve me dekada cenon rëndë të drejtat dhe liritë e qytetarëve për të pasur një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm kohor.
2. KGJK të bëjë një analizë gjithëpërfshirëse të ngarkesës së Divizioneve Civile me lëndë, në mënyrë që të ketë mundësi të ndërmarrë hapa për stabilizimin e këtyre divizioneve, veçanërisht sa i përket lëndëve të pazgjidhura cilat barten vit pas viti.
3. Gjyqtarët të përmbushin normën e tyre orientuese të përcaktuar në KGJK.
4. KGJK të mbajë përgjegjës gjyqtarët për mos zgjidhje të lëndëve aq sa është e përcaktuar me normën orientuese, por se paraprakisht, KGJK të rishikojë rregulloren që përcakton këto norma.
5. KGJK të bëjë një analizë të detajuar mbi gjendjen me lëndë civile në sistemin e drejtësisë, dhe të nxjerrë një plan të detajuar për uljen e numrit të lëndëve civile në sistemin e drejtësisë.
6. Gjyqtarët mos të tregojnë qasje selektive dhe trajtim të pabarabartë të palëve, duke trajtuar lëndë të reja para atyre të vjetra, përjashtimisht rasteve kur prioriteti është i caktuar me ligj apo vendim të KGJK-së. Gjyqtarët të cilët veprojnë në këtë mënyrë të mbahen përgjegjës nga KGJK.
7. Gjyqtarët të evitojnë pengesat e vazhdueshme procedurale të cilat shkaktojnë tejpgjatje të tërësisë së procedurës civile.
8. Gjykatësit e Gjykatës së Apelit të evitojnë praktikën që të njëjtat lëndë t'i kthejnë në ri-gjykim disa herë.
9. KGJK përmes procesit të vlerësimit të performancës të mbajë përgjegjës gjyqtarët, lëndët e të cilëve kthehen vazhdimisht në rigjykim.
10. Gjykatat të kujdesen që zbatimi i ligjit të bëhet në mënyrë unike.
11. Gjyqtarët në kuptim të zbatimit të nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të zbatojnë jurisprudencën dhe standardet e GjEDNj-së.
12. Gjykatat të trajtojnë me prioriteti të madh lëndët që janë duke pritur me dekada.